



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
FAKULTETI JURIDIK - STUDIME MASTER
DREJTIMI: JURIDIKO-PENAL

TEMA:
DHUNA NË FAMILJE ME VËSHTRIME TË POSAÇME, KEQTRAJTIMI
I FËMIJËVE NË RRETHINËN E FERIZAJIT PËR PERIUDHË 2014-2020

Mentori:
Prof.dr.Ismail ZEJNELI

Kandidati/ja:
Hatixhe MJAKU ELEZI

Tetovë, 2020

PËRMBAJTJA

H Y R J E	5
Abstrakt.....	Error! Bookmark not defined.
Aspekti metodologjik	7
1. Objekti studimit të temës shkencore	7
2. Qëllimet e hulumtimit	7
3. Hipotezat e hulumtimit	8
4. Hipoteza e përgjithshme	9
5. Hipoteza të veçanta	9
6. Metodologjia e hulumtimit.....	10
7. Metoda komparative	10
8. Metoda historike	10
9. Metodat dhe teknikat e kërkimit	10
10. Metodë e përdorur në këtë punim është edhe metoda bibliografike	Error! Bookmark not defined.
KAPITULLI PARË	12
DHUNA NË FAMILJE-VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME	12
1.Kuptimi nocioni i dhunës në familje.....	12
2. Karakteristikat dhe mënyrat e manifestimit të dhunës	13
3. Historiku i dhunës në familje	14
4. Llojet e dhunës në familje	15
4.1. Dhuna fizike.....	16
4.2. Dhuna Psikologjike	17
4.3. Dhuna seksuale	18
4.4.Dhuna ekonomike	21
KAPITULLI DYTË	22
DHUNA NË FAMILJE PROFILI I VIKTIMAVE NGA DHUNA NË FAMILJE	23

1. Përkufizimi i viktimave të dhunës së familje.....	23
2. Të drejtat e viktimave të dhunës në familje	24
3. Cilat janë subjektet që mbrohen nga ligji për dhunën në familje.....	25
3.1. Në shumicën e rasteve , viktimat janë gra dhe fëmijë.....	26
4. Masat mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje.....	28
KAPITULLI I TRETË	30
DHUNA NË FAMILJE ME VËSHTRIME TË POSAÇME, KEQTRAJTIMI I FËMIJËVE NË RRETHINËN E FERIZAJIT PËR PERIUDHË 2014-2020	30
1. Njohuri themelore	30
2. Dhuna ndaj fëmijëve në familje pas luftës në Kosovë	32
3. Format e dhunës ndaj fëmijëve	32
4.Pasojat e dhunës ndaj fëmijëve	33
5.Format e dhunës kundrejt fëmijëve kanë pasoja socio-ekonomike.....	34
6.Dhuna në familje në Ferizaj	35
6.1. Shkaqet e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit	36
6.2. Dhuna që ndodh brenda shtëpisë shpesh konsiderohet si çështje	36
6.3. Vendimi për të mos e braktisur kryesin shpesh konsiderohet zgjedhje e menduar e viktimës...37	
7. Mos paraqitja e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit	38
8. Raste nga praktika në Ferizaj I.....	40
9. Raste nga praktika në Ferizaj II	41
10. Raste nga praktika në Ferizaj III.....	41
KAPITULLI I KATËRT	44
PARANDALIMI I DHUNËS NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	44
1.Institucionet shkollore dhe pozita e shtrimit të dhunës ndaj nxënësve	44
2.Organet e rendit dhe të drejtësisë duhen të ndërmarrin masa adekuate sipas ligjit.....	46
3.Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.....	47
4.Korniza ligjore nacionale dhe ndërkombëtare	50
5.Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj grave.....	53

PJESA E II	55
STUDIMI HULUMTUES EMPIRIK DHE PIKËPAMJET PËRFUNDIMTARE ANKETUESE...	55
1. Pikëpmajet hulumtuese dhe rezultatet anketuese.....	56
2. Gjendja reale dhe të dhënat hulumtuese	56
3. Parë në këndvështrimin hulumtues dhe atë empirik	57
4. Përfshirja e grupmoshave të ndryshme	58
5. Të dhënat e përpunuara anketuese	58
6. Roli i punimit empirik gjatë studimit.....	59
7. Analiza e rezultateve të fituara nga pyetësi anketues	60
8. Qasja e arsyeshmëri metodologjike.....	60
9. Anketa procedurale e studimit në terren	62
Përfundimi.....	72
BIBLIOGRAFIA.....	75
Wep-grafia	776

HYRJE

Në këtë temë të masterit titulluar: „*Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020*„, bëhet fjalë për dhunën në familje me vështirime të posaçëm keqtrajtimin e fëmijëve në rrethinën e Ferizajit. Dhuna në familje me theks të veçantë dhuna ndaj fëmijëve dhe të rinjve është dhe mbetet një nga fenomenet më të përhapura dhe një nga krimet më të paraportuara në shoqërinë shqiptare s'i në Republikën e Kosovës ashtu edhe në hapsirat shqipfolëse dhe kjo e bënë të pamundur matjen me saktësi të përmasave të një fenomeni të tillë. Dhuna në familje është trajtuar më shumë si një problem individual i cili i përket vetëm anëtarëve të familjes dhe jo shoqërisë. Sa më shumë që mësojmë mbi pasojat që le dhuna tek fëmijët, aq më të qartë bëhen masat që duhen adresuar. Si për periudhën afatshkurtër dhe atë afatgjatë, ekspozimi ndaj dhunës gjatë fëmijërisë ka pasoja jashtëzakonisht negative s'i për shëndetin mendor dhe atë emocional e fizik. Provat sugjerojnë se e gjithë shoqëria mund të dëmtohet nëse një fëmijë vuan në këtë formë.

Shikuar në këtë prizëm, mund të vlerësojmë se punimi shkencor në fjalë ka për objekt studimi dhunën në familje dhe keqtrajtimin e fëmijëve. Familja si një njësi bashkëjetese mes anëtarëve të familjes i ka të rregulluara të drejtat dhe detyrime familjare si prindërit ndaj fëmijëve ashtu edhe të drejtat e fëmijëve ndaj prindërve dhe aty ku shkelen këto të drejta paraqiten devijimet në familje dhe në të shumtën e rasteve përfundojnë në dhunë familjare.

Përkatësisht, ky problem duhet të trajtohet s'i problem juridiko-penal, ekonomik dhe shoqëror por edhe të karakterit moral. Mjaft fakte provojnë se në familjen shqiptare të ditëve tona, fëmijët rrallë u nënshtrohen formave të ndryshme të dhunës së prindërve të tyre së paku deri në fund të moshës së adoleshencës. Të dhënat që janë marrë nga anketimet pohojnë se ndaj fëmijëve të tyre ushtrohet dhunë jo vetëm nga babai, por edhe nga nëna, si në familjet shqiptare rurale, ashtu dhe në ato qytetare. Studimet dëshmojnë se jo rrallë her si baballarët ashtu edhe nënat janë pothuaj njëlloj të dhunshëm ndaj fëmijëve të tyre. Nënata ushtrojnë më shumë dhunë ndaj vajzave të tyre, duke e justifikuar këtë me mendësitë se dhuna është e domosdoshme si mjet detyrimi që vajzat të mos marrin rrugë të keqe apo devijuese, se dhuna ka shpëtuar shumë vajza adoleshente nga degjenerimi e kausi shoqëror që përjeton Republika e Kosovës në këtë rast edhe Komuna e Ferizajit, se dhuna ndaj fëmijëve apo vajzave është pjesë e përgjithësisë dhe e

kontrollit të nënave ndaj tyre, se vajzat më mirë të zemerohen me nënat, që i detyrojnë dhe me dhunë të shkojnë në rrugë të mbarë, se sa t'i mallkojnë gjithë jetën për shkarjet nga lëshimet liberale të tyre.

Mbetemi në shpresë se në vijim të punimit do t'i vërtetojmë hipotezat e parashtrua në për objektin e studimit të këtij punimi shkencor të temës së masterit: ***„Dhuna në familje me vështrime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020,,*** punim shkencor e hulumtues i cili do të ndihmojë sa do pak edhe te studjuesit e rinjë në këtë preukupim, problematikë mbarëshoqërore me synimin e vetëm për të prevenueuar dhe parandaluar veprat penale kundër familjes dhe abuzimeve ndaj fëmijëve.

1. Aspekti metodologjik

Tema e shtruar në kuptimin studimor dhe në kuadër të programit për studime pasdiplomike, na detyroi që të bashkëpunojmë për studim të mirëfilltë me Ministrinë e Punëve të Brendshme-Njësia rajonale e punëve të brendshme Ferizaj, Ministrinë për mirëqenie sociale Qendrën për mbrojtje sociale Ferizaj, Gjykatën Themelore-Ferizaj, Ministria e shëndetësisë, Ministria e arsimit dhe shkencës, njësitet e vetëqeverisjes lokale si dhe Organizatat Jo qeveritare, që të realizojmë studimin bazë të titulluar: ***Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020***, Ky studim bazë ofron një panoramë të ecurisë në luftën kundër dhunës në familje me theks të veçantë të dhunës ndaj fëmijëve dhe të rinjëve, me qëllim që të ndihmojë në hartimin e fushave ku mund të ndërhyhet dhe të nxjerrë përfundime për të përmirësuar situatën.

2. Objekti studimit të temës shkencore

Qëllimin primar studimi shkencor i masterit ka dhunën në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020. Përsa i takon të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve dhe grave, në Republikën e Kosovës, praktikat e mbledhjes së të dhënave sociale, gjyqësore, administrative dhe mbi bazën e shërbimeve do të grumbulloj dhe analizojmë të gjitha dukuritë devijuese. Kur bëhen përpjekje për të matur shkallën dhe natyrën e problemit, kjo gjë paraqet një sfidë. Sidoqoftë, statistikatat zyrtare të mbledhura në mënyrë sporadike dhe anketimet e kryera nga organizatat e grave tregojnë se fenomeni është i përhapur.

3. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi kryesor i studimit është të vlerësojë kapacitetet dhe aftësinë e Policisë në bashkëpunim me institucionet kompetente të lartpërmendura për të ofruar shërbime për të adresuar, hetuar dhe zvogëluar rastet e dhunës në familje dhe ndaj fëmijëve, si dhe shkallën e koordinimit mes tyre për trajtimin e përshtatshëm të rasteve të dhunës në familje, konkretisht:

- Për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, në veçanti ata që janë viktimë të dhunës;

- Për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve;
- Të identifikojë përhapjen e formave të dhunës në familje posaçërisht ndaj fëmijëve që ndodhin ose kanë ndodhur;
- Të identifikojë grupet veçanërisht të prekshme nga dhuna në familje;
- Të identifikojë pikat e forta dhe burimet e Policisë në popullsi për të parandaluar, përgjigjur dhe hetuar rastet e dhunës në familje;
- Të identifikojë strategjitë e ndërhyrjes për parandalimin dhe hetimin e dhunës në familje dhe nevojave të viktimave,
- Mbrojtjen e viktimave, si dhe
- Ngritjen e vetëdijes së popullsisë për paraqitjen/denoncimin e dhunës në familje
- Nxitur adoptimin, implementimin dhe monitorimin e strategjive të integruara kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna;
- Përforcuar bashkëpunimin ndërkombëtar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për të mbrojtur fëmijët nga dhuna.

Shikuar në këtë prizëm, për sa i përket qëllimit të studimit shkencor mund të vlerësojmë se ka për qëllim aspektin historik të shfaqjes së dhunës ndaj fëmijëve dhe grave. Qëllim primar mbetet studimi i shkaqeve dhe pasojave që ka kapluar shoqërinë shqiptare siç është prishja e raportve ndërfamiljare e cila rezulton me dhunë në familje, dhunë ndaj grave, dhunë ndaj fëmijëve, me këtë rast përfaqësohet forma e përhapur e dhunës, ku do të hulumtohet se kush janë kryesit e veprave penale më së shumti partnerët meshkuj ose bashkëshortët aktualë ose të mëparshëm.

4. Hipotezat e hulumtimit

Në këtë temë të masterit titulluar: *„Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020,,* kemi përcaktuar funksionin e studimit të dhunës në rajonin e Ferizajit si kategori devijuese që në vetet ngërthen veprën penale që nënkupton se dhuna është fenomen që dita ditës rrit shqetësimin për përhapjen e tij. Shikuar në këtë prizëm hipotezatat e hulumtimit shkencor mund të vlerësojmë se duhet të merret në studimi e sipër shkaqet dhe arsyet e heshtjes së viktimave , sepse dhuna është element bazë me të cilën nënkuptojmë se viktimat nga momenti i viktimizimit mbyllet në vetëvete analizon se s'i ta denoncojë aktin e viktimizimit, duke i marrë parasysh pasojat eventuale, kush

mund t'i sigurojë strehim dhe siguri që mos të rrëndohet akoma më shumë rrezikshmëria ku mund të rrezikojë edhe antarët tjerë të familjes. Në këtë rast viktimat fatkeqësisht, zgjedhin rrugën e heshtjes apo mosdenoncimin e viktimizimit nga besimi i ulët në institucione për siguri personale e familjare.

Shikuar në aspektin metodologjik, për hulumtin shkencor të temës kemi të *paraparë dy hipoteza*: Hipoteza e përgjithshme dhe e veçantë që do të zhvillojmë procesin e hulumtimit shkencor.

5. Hipoteza e përgjithshme

Duke marrë për objekt studimi dhe analizimi, përhapjen e formave të dhunës ndaj fëmijëve dhe antarëve të familjes që ndodhin ose kanë ndodhur në periudhën pesëvjeçare të studimit të temës ka për objekt të identifikojë grupet, veçanërisht të prekshme nga dhuna në familje si; shkaqet e viktimizimit, pasojat nga dëmi i shkatuar, shkaktarët e raporteve ndërpersonale, raportet mes prindërve dhe fëmijëve s'i dhe antarëve tjerë brenda familjes, pasojat primare dhe ato të rënda, sfidat dhe strategjitë për të ndihmuar dhe prevenuar për këtë kategori të rrezikuar në familje dhe shoqërinë tonë bashkëkohore në përgjithësi.

6. Hipoteza të veçanta

-  Shkaqet e paraqitjes së dhunës ndaj fëmijëve dhe raportet ndër-prindërore,
-  Mbrojtja nga kërcnimet dhe komunikimi agresiv, që në të shumtën e rasteve përfundojnë në dhunë dhe me pasoja të rënda për viktimat,
-  Aspekti ligjor dhe moral detyron ç'do pejstarë të familjes me detyrim që të mos cenojë dinjitetin personal të tjetrit në raportet familjare.
-  Konventat ndërkombëtare mbrojnë të drejtave të fëmijëve.
-  Në kuadër të instrumentave juridike do të analizohet funksionimi institucional dhe korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të antarëve të familjes nga kërcnimet dhe ushtrimin e dhunës eventuale,
-  Legjislacioni kushtetues dhe normat juridike në fuqi të Legjislacionit të Republikës së Kosovës do të analizohen dhe interpretohen në aspektin e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve si e drejtë universale.

7. Metodologjia e hulumtimit

Përkujdesje të veçantë do të kemi për metodologjinë e hulumtimit dhe metodat që i kemi zhvilluar do të jenë me kushtëzime shumë dimensionale lidhur me dhunën dhe cënimin e të drejtave të njeriut s'i dhe të gjitha karakteristikat procedurale e gjyqësore për dhunën ndaj fëmijëve dhe të rinjëve.

Do të zbatojmë gjatë hulumtimit procedural e shkencor këto metoda shkencore si;
Metoda komparative dhe metoda historike.

8. Metoda komparative

Kjo metodë shërbenë për të paraqitur disa qasje të veçanta, në lëminë e të drejtave personale dhe shkeljet e të drejtave shoqërore, nga përkufizimet eventuale në labirintet gjyqësore për dhunën në familje si fenomen i përgjithshme apo individuale dhe forma të ndryshme të paraqitjes së dhunës ndaj fëmijëve nga relacionet ndërfamiljare apo ndërprindërore

Kemi shfritëzuar edhe metodat e tjera ndihmëse gjatë hulumtimit shkencor siç janë;

9. Metoda historike

Metoda historike do të na shërbej për mbledhjen dhe përpunimin e fakteve s'i pikëpamjet për viktimat dhe viktimizimin e tyre dhe pjesëmarrësit në dhunën familjare analizuar aspektin historik, juridik edhe atë të gjendjes aktuale dhe vijuese për shkaqet dhe pasojat e dhunës ndaj fëmijëve dhe antarëve tjerë brenda raporteve ndërfamiljare.

10. Metodat dhe teknikat e kërkimit

Duke u mbështetur në metodat, metodologjinë dhe teknikat e kërkimit shkencor të temës së punimit titulluar: „*Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020,*„ është e domosdoshme të zbatohet metodologjia universale e standareve bashkëkohore që kemi përzgjedhur gjatë hulumtit shkencor.

Parë në këtë prizëm metodologjinë shkencore e hulumtuese disa nga metodat e përdorura gjatë përgaditjes së këtij punimi theksojmë se si metodë themelore hulumtuese në shkrimin e

këtij punimi është përdorur metoda përshkruese-analitike si qasje kryesore metodologjike. Me anë të kësaj metode jemi përpjekur të orientohemi në të përsosurit e njohurive në lidhje me dukurinë dhunës ndaj fëmijëve dhe cënimit të dinjitetit njerëzor e atë familjare. Po ashtu, jemi përpjekur që të dhënat e marra s'i nga terreni ashtu edhe të dhënat zyrtare nga institucionet dhe ato statistikore t'i analizojë, t'i krahasojmë, t'i kundërshtojmë, t'i vlerësojë si dhe t'i interpretojmë në mënyrë sa më objektive dhe të argumentuara në aspektin shkencor e metodologjik.¹Vepruar në bazë intervistave me *fokus grupet* dhe intervista të mirëfillta me qëllim që punimi shkencor t'i plotësojë të gjitha kriteret dhe standardet bashkëkohore si ato akademike ashtu edhe ato shkencore e hulumtuese.

¹ Në vijim të hulumtimit shkencor të temës „Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020,, kemi përdorur dy lloje të intervistave, si në vijim: intervista me *fokus grupet* dhe intervista të mirëfillta. Intervistën me fokus grupe e kam përdorur për hulumtimin e opinionëve të profesionistëve që punojnë në institucionet relevante për çështjet e procedimit të të gjitha llojeve të dhunës në familje, me qëllim që të kuptojmë opinionet e tyre dhe qëndrimet e kundërta për çështje të caktuara dhe trendet aktuale.

KAPITULLI PARË

DHUNA NË FAMILJE-VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME

1. Kuptimi *nocioni* i dhunës në familje

Dhuna në familje, veç *përkufizimit që i jep Deklarata e Kombeve të Bashkuara* për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, cituar më lart, ligji e përkufizon: „çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cënimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare”. Në shumicën e rasteve dhuna drejtohet: ndaj grave brenda çiftit, ndaj fëmijëve nga prindërit, midis vetë fëmijëve, nga fëmijët drejtuar prindërve, ndaj të moshuarve, ndaj personave me paafësi. Me *termin dhunë në familje* nënkuptojmë malltretim, ofendim të ashpër, kërcënim të sigurisë, lëndim trupor, dhunë në baza gjinore apo lloj tjetër të dhunës psikike apo fizike e cila shkakton ndjenjë pasigurie, ndjenjë rreziku apo frike ndaj partnerit bashkëshortor, ndaj prindërve apo fëmijëve apo personave të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore apo në një amvisëri të përbashkët, si dhe ndaj partnerit të mëparshëm martesor apo ndaj personave me të cilët kanë fëmijë apo janë në marrëdhënie të afërta personale. Dhunë: do të kuptohet çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik.²

Viktima në rastet e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare, janë personat mbi të cilët është ushtruar dhunë me veprim apo mosveprim nga një person tjetër, që ka sjellë si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik. Dhunues/e në rastet e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, përpara organeve kompetente. Sipas ligjit për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familje të Republikës së Kosovës, *me nocionin* dhunë në familje nënkuptohet keqtrajtimi, ofendimi, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhuna gjinore apo dhuna tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, rrezikimit

² Ligji nr. 03/L-182 “Për mbrojtje nga dhuna në familje” (LMDHF). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: VITI V / NR. 76 / 10 Gusht 2010.

ose frikës, duke përfshirë edhe kërcënime për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve ose personave tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose ekonomi të përbashkët familjare, si dhe ndaj bashkëshortit të tanishëm apo të mëparshëm, partnerit jashtëmartesor ose personave që kanë fëmijë të përbashkët ose janë në marrëdhënie të afërta personale, pa marrë parasysh nëse kryerësi e ndan ose e ka ndarë vendbanimin e njëjtë me viktimën ose jo.³

Dhuna është fenomen që dita ditës rrit shqetësimin për përhapjen e tij. Kodi penal i Republikës së Kosovës, me dhunë në familje nënkupton maltretim, fyerje të vrazhdët, cënim të sigurisë, lëndim fizik, dhunë seksuale apo psikologjike ose fizike me çka shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, kërcënim ose frikë ndaj bashkëshortit, prindërve, fëmijëve dhe personave të tjerë të cilët jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore ose shtëpi të përbashkët, si dhe ndaj ish-bashkëshortit apo personave, të cilët kanë fëmijë të përbashkët ose ndodhen në marrëdhënie të ngushta personale.⁴

Në ligjin për familje, dhuna në familje nënkupton sjelljen e një anëtari të familjes, i cili me anë të përdorimit të forcës, kërcënimit dhe frikësimit kryen lëndime fizike, abuzim emocional apo seksual, shfrytëzim material apo shfrytëzim të mundit të një anëtari tjetër të familjes. Në kohën tonë familja e ka humbur *qetësinë* e cila pritet ta karakterizojë. Ajo është e kërcënuar jo vetëm nga faktorë tradicionalë, si vdekja, sëmundjet, katastrofa të ndryshme, varfëria, etj., por dhe ata “jo tradicionalë” si sjelljet devijante, konfliktet gjithfarëshe, dhuna, alkolizmi, përdorimi abuziv i drogës, braktisja, sëmundjet seksualisht të trasmetueshme, etj.”. Pra familja është një strukturë që përmbledh një mori marrëdhëniesh dhe rolesh dhe si e tillë është e ndjeshme nga dhuna që ushtrohet brenda sajë.

Duke u bazuar në vlerat universale të familjes, Organizata e Kombeve të Bashkuara e përkufizon dhunën në familje si një akt që rezulton, ose ka shumë mundësi të rezultojë në dëmtim fizik, seksual ose mendor duke përfshirë kërcënime ose akte të ngjashme, shtrëngimet ose heqjen arbitrare të lirisë⁵.

³ Ligji për parandalim, pengim dhe mbrojtje nga dhuna në familjes. 138/20 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Prishtinë: VITI V / NR. 76 / 10 Gusht 2010.

⁴ Kodi penal i Republikës së Kosovës.

⁵ World Health Organization <http://www.who.int/mediacentre/factsheets/fs239/en/> e vizituar herën e fundit me 24.2.06.

2. Karakteristikat dhe mënyrat e manifestimit të dhunës

Dhuna ndodh mes njerëzish të të gjithë moshave, racave dhe prejardhjeve s'i socio-ekonomike dhe kulturoro-arsimore. Në të shumtën e rasteve, protagonistët kryesorë janë bashkëshortët, ku burri abuzon me gruan, por nuk janë të anashkaluar edhe fëmijët të cilët do të kisha thënë se pësojnë më shumë nga dhuna e shfaqur s'i në aspektin fizik ashtu edhe në aspektin psikofizik. Dhuna familjare apo siç mund të quhet ndryshe edhe abuzim familjar, ndodh kryesisht ndërmjet njerëzve në marrëdhënie intime, këtu përfshihet edhe dhuna mes dy ish-bashkëshortësh, të fejuarish apo të dashuruarish. Të gjitha marrëdhëniet abuzive kanë karakteristika të ngjashme.

Në të gjitha rastet abuzuesi ose kryerësi i dhunës ka si qëllim ushtrimin e fuqisë dhe kontrollit mbi partneren e tij, për arsye se dhuna është një mjet për të ushqyer frikën tek partnerja, si dhe për të marrë në dorë fuqinë dhe kontrollin e një marrëdhënie. Kryerës i dhunës në familje është personi që ushtron ose paditet përpara organeve kompetente për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare. Dhunues apo shkelësi i të drejtave brenda familjes mund të jetë çdo pjestar i bashkësisë brenda familjes. Dhuna mund të manifestohet në forma të ndryshme si ajo psikologjike, fizike, abuzim seksual, neglizhim. Përfshin veprime dhe sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues të fëmijës nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën.⁶

3. Historiku i dhunës në familje

Dhuna në familje nuk është vetëm një dukuri shqiptare, por është karakteristike se në historinë tonë, në asnjë dokument që përmend kodet e identitetit tonë kulturor si komb, nuk është as i shkruar dhe as i thënë, që dhuna i zgjidh çështjet me të cilat përballet krenaria e familjes, por

⁶ Dhuna në familje është një nga format e krimeve më pak të raportuara dhe zakonisht konsiderohet si një çështje private, si rrjedhojë nuk dihet me saktësi përmasat dhe frekuenca e fenomenit. Megjithatë studimet e kryera tregojnë se dhuna në familje, sidomos ajo ndaj grave dhe vajzave, është rritur gjatë periudhës së pandemisë. Vështirësia e grumbullimit të informacionit mbi dhunën në familje vjen dhe si pasojë e gjendjes ekonomike të viktimave, të cilat në shumë prej rasteve janë të varfra sidomos në vendin tonë dhe janë individët të cilët kanë aksesin më të kufizuar ndaj informacionit për të drejtat e tyre, shërbimeve sociale, ndihmës juridike apo dhe vëmendjes së medias.

realiteti është se ndryshe nga vendet e tjera apo nga statistikat, rezulton se një ndër tri gra aprovon se ka pësuar dhunë në familjen e saj.

Është e natyrshme që çdo person, familje apo shoqëri sot duhet të luftojë për më të mirën për veten e tij dhe për pjesëtarët e tjerë nga njëra anë, dhe nga ana tjetër gjithashtu duhet të kujdesemi dhe të pranojmë gjithçka, që na ka falë Zoti dhe natyra.

Nga ana tjetër dështimi duke mos qenë më një familje normale i detyron gratë shqiptare, që të sakrifikojnë jetët e tyre për hir të fëmijëve, duke duruar fyerje e sharje madje dhe nga njerëzit e bashkëshortit, por që përgjigjen e japin të shkurtër. Duke qenë se fëmijët akoma se pranojnë realitetin, se kjo jetë nuk funksionon kështu, bëjnë të pamundur mbajtjen e familjes gjatë të bashkuar. Duke privuar të gjitha të drejtat dhe dëshirat e tyre. Ndikimi në familje i këtyre tragjedi, ku fëmijët janë në mes, gjithçka mund t'ia vendosësh emrin por vetëm jetë jo.

Dhunë në familje nënkupton⁷ një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në: përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes; çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë ose mënyrave tjera të veprimit në marrëdhëniet brenda familjes.⁸

4. Llojet e dhunës në familje

Shikuar në themelsinë e lëndës së studimit të dhunës në familje e drejta familjare si shkencë studimi llojet e dhunës në familje i kategorizon në: dhunë fizike, dhunë psikologjike ose emocionale, dhunë seksuale dhe dhunë ekonomike, në vazhdimt do t'i japim disa definicione të përzgjedhura nga shkenca e së Drejtës familjare.

⁷ Ligji nr. 03/L-182 “Për mbrojtje nga dhuna në familje” (LMDHF). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: VITI V / NR. 76 / 10 Gusht 2010.

⁸ Këtu del në pah sakrifica e nënave shqiptare, të cilat mundohen të bëjnë të mundur që jeta e fëmijëve të tyre, adoleshencat periudha më e vështirë për rritjen e një fëmije, të duket si jeta e çdo fëmije të një familjeje normale, duke mohuar të gjitha të drejtat e tyre, duke mos takuar madje as prindërit e tyre, që i kanë lindur e rritur, që të mos bëhet zhurmë në familje, që të mos mërziten dhe fëmijët e tyre.

4.1. Dhuna fizike

Dhuna fizike përfshin: shtyrjen, goditjen, gërvishtjen, pickimin, kafshimin, hedhjen, mbylljen në shtëpi, goditjen me objekte të ndryshme, kërcënimin me thikë ose me armë tjetër, refuzimin për ta ndihmuar gruan kur ajo është shtatzënë ose e sëmurë, deri në formën më të rëndë *vrasjen*, vrasjen e mbetur në tentativë, plagosjen, etj.⁹

Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës, mjeteve të kufizimit të lirisë ose armëve nga ana e një personi për shembull, armë zjarri, thikë apo ndonjë objekt tjetër, për të fituar dhe mbajtur kontrollin mbi një person tjetër. Ekzistojnë katër lloje të ndryshme të dhunës fizike që mbështeten tek shkalla e intensitetit të dhunës dhe mundësia e shkakimit të lëndimeve fizike.

-  *Dhuna fizike e moderuar* përfshin një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme fizike: goditjet me shkelma, hedhjet tutje, shtyrjet, tërheqjet zvarrë, goditjet me shuplakë dhe/ose shkuljet e flokëve.
-  *Dhuna fizike e rëndë* përfshin një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme fizike: goditjet, rrahjet, djegiet me qëllim, marrjet e frymës ose mbytjet, dhe/ose kërcënimet me armë ose përdorimi i një arme kundër personit.
-  *Dhuna fizike me armë* përfshin kërcënimet dhe/ose goditjet me armë ose me ndonjë objekt tjetër që mund të shkaktojë lëndime fizike.
-  *Dhuna fizike me lëndime rënduese* përfshin dhunën fizike që i shkakton lëndim fizik një personi tjetër.

Dhuna fizike është një formë dhune që viktimat e kanë më të lehtë për ta përceptuar dhe për ta pranuar për vetë natyrën e ushtrimit të sajë dhe të gjurmëve të dukshme që ajo lë tek viktima.

Dhuna fizike jo vetëm që lë pasojë të rënda të viktimave, por, individët me shqetësime të tilla janë përqendruar kryesisht tek të depresuarit dhe konkluzioni themelor është se subjektet klinikisht depressive kanë keqësim të përgjithshëm të kujtesës së tyre të lirë dhe shumë pasoja afatgjate negative viktimizuese.

⁹ Abuzimi emocional është shkatërrimi i ndjenjës së vetëvlerësimit dhe të vetëbesimit të një individi. Kjo mund të përfshijë kritikën e vazhdueshme, poshtërimin, përçmimin e aftësive të një personi, sharjet, degradimin dhe dëmtimin e marrëdhënieve të dikujt me fëmijët e tij ose të saj.

4.2. Dhuna Psikologjike

Dhuna Psikologjike, përfshin injorimin e ndjenjave të bashkëshortes, kritika të vazhdueshme, kundërshtim i vazhdueshëm i mendimeve, poshtërim në publik ose privatisht, përpjekje për ta bindur partneren se dhunën e meriton nga veprimet e veta, kërcënim i partneres për tradhëti bashkëshortore, shenja xhelozie të vazhdueshme, kërcënimin për marrjen e fëmijëve, mbajtje fshehur e parave, mbajtje në shtëpi pa punë, abuzim me fëmijët, thirrje me emra poshtërues etj. Shumica e abuzimeve psikologjike ndodhin në kontekstin e formave të tjera të abuzimit, si ai verbal, ekonomik dhe izolimi social.¹⁰ Burrat që ushtrojnë abuzim fizik, zakonisht ushtrojnë edhe abuzim psikologjik.

Dhuna psikologjike, për vetë natyrën e saj, është shumë e vështirë për t'u evidentuar, pasi nuk lë gjurmë të dukshme, si dhuna fizike, mirëpo sulmet verbale, poshtërimi, kërcënimi, kufizimi mund të jenë edhe më të dëmshme se sulmi fizik. Ekzistojnë katër lloje të ndryshme të dhunës psikologjike:

-  Dhuna verbale kur gruaja kritikohet, fyhet, poshtërohet dhe/ose asaj i flitet në një mënyrë që sulmon karakterin e saj dhe i trondit ndjenjën e vetë-vlerësimit dhe vetë-besimit.
-  Kërcënim psikologjik kur gruaja kërcënohet dhe tek ajo shkaktohet ndjenja e frikës nëpërmjet kërcënimeve për ta lënduar fizikisht atë dhe/ose persona të tjerë të afërt me të, dhe/ose për të shkatërruar diçka të rëndësishme për të duke i tronditur kështu ndjenjën e sigurisë.
-  Sjellje kontrolluese kur gruaja shpërfillet, mbahet nën kontroll dhe izolohet, dhe të qenit xheloz dhe akuzimi i gruas se nuk është besnike, për t'ia tronditur ndjenjën e vetë-vlerësimit dhe vetë-besimit.
-  Dhunë ekonomike mbajtja nën kontroll e parave të shtëpisë, përfshirë edhe pagën e gruas në ato raste kur ajo është e punësuar jashtë shtëpisë.

¹⁰ Ligji nr. 05/L-025 “Për shëndetin mendor”; dhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020 (SKMDHFPV).

Dhuna psikologjike përfshin një gamë sjelljesh që kanë për qëllim të kritikojnë dhe poshtërojnë, të mbajnë nën kontroll dhe izolojnë, të trembin dhe shkaktojnë frikë, dhe të sulmojnë karakterin e një gruaje dhe të shkatërrojnë ndjenjën e saj të vetë-vlerësimit, vetë-besimit, dhe sigurisë. Nga ana tjetër mund vlerësojmë se tek emocionet konfliktuale ku bënë pjesë edhe zemrimi, shmangie dhe neveri, të cilat lidhen me shkatërrimin e kufijve të egos, në këtë vështrim, edhe hipoteza katarsisit *catharsis* pohon se zemrimi zvoglohet kur dikush e çliron atë nëpërmjet veprimeve apo *fantazive agresive*¹¹ këto çlirime zemrimi ndodhin në ambijentet familjare, në raport prind-fëmijë dhe e kundërta ku edhe fillon dhuna psikologjike në marrëdhënie të përditshme familjare si në komunikimin devijues ashtu edhe me dhunë psikologjike..

4.3. Dhuna seksuale

Dhuna seksuale, përfshin: trajtimin e partneres ose partnerit si objekt seksual, detyrimin për të bërë striptizëm, detyrimin për të bërë seks, këmbënguljen për të prekur e për të bërë gjithçka dëshiron, detyrimin për të bërë seks me dikë tjetër, kryerjen e akteve seksuale sadiste, detyrimin e partneres të bëjë seks pas abuzimit fizik ose si kusht për të ruajtur marrëdhënien e tyre, kryerjen e marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore etj. Është vërejtur se bashkëshortët apo partnerët që ushtrojnë këtë formë dhune, duan të demonstrojnë forcën dhe aftësinë e tyre për të sunduar dhe për të poshtëruar viktimën.

Dhuna seksuale përfshin detyrimin, shtrëngimin ose tentativën për të shtrënguar një person për të bërë kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimin e tij. Dhuna seksuale përfshin, por nuk kufizohet me përdhunimin bashkëshortor, sulmet në pjesët seksuale të trupit, detyrimin për të bërë seks pas ushtrimit të dhunës fizike ose trajtimi në mënyrë seksualisht poshtëruese. Dhuna seksuale kryhet nga bashkëshortët ose partnerët intimë dhe nga anëtarët e familjes brenda kontekstit të martesës, të marrëdhënieve dashurore dhe familjes.¹²

Dhuna seksuale, dhuna mbi përkatësinë gjinore dhe dhuna ndaj femrave janë termine, të cilët gjatë përdorimit, shpesh tregojnë të njëjtën çështje. Të gjitha këto shprehje i takojnë shkeljes

¹¹ Zenel Orhani „Psikologjia e emocioneve”-faq.96-97. Tiranë, 2011.

¹²Ligji nr. 03/L-182 “Për mbrojtje nga dhuna në familje” (LMDHF). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti V / Nr. 76 / 10 Gusht 2010.

së të drejtave themelore të njeriut, duke i shtuar jetë roleve stereotipe, të bazuara në gjininë e individit dhe, në këtë mënyrë, individët i zhveshin nga dinjiteti njerëzor dhe vetëvendosja, duke penguar kështu zhvillimin njerëzor. Këto kanë të bëjnë me të padrejtat fizike, seksuale dhe psikologjike, që e mbështesin varësinë e femrës, duke ia shtuar periudhën kohore ndikimit dhe kontrollit të mashkullit mbi to. Deri sa dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore ka ndikim shkatrrues në jetën e grave dhe vajzave, që e përbëjnë shumicën e viktimave të mbijetuarëve, kjo e pengon edhe zhvillimin e burrave dhe djemëve. Eliminimi i dhunës dhe i pabarazisë, bazuar në përkatësinë gjinore, ndihmon që të forcohet e tërë bashkësia. Termi dhuna e bazuar mbi përcaktësinë gjinore përdoret në mënyrë që të dallohet dhuna e përgjithshme nga dhuna e cila i godet individët apo grupet individësh, varsisht nga përkatësia e tyre gjinore.

Termi dhuna ndaj femrës ka të bëjë me çfardo veprë të dhunës, bazuar në përkatësinë gjinore, e që ka për pasojë ose sigurisht do ta ketë si pasojë të padrejtën fizike, seksuale apo psikologjike, të ushtruar mbi gratë dhe vajzat, qoftë kjo dhunë të ketë ndodhur në situata private apo publike.

Dhuna seksuale, përfshirë këtu edhe eksploatimi e keqtrajtimi, ka të bëjë me çfardo veprë seksuale, tentim apo kërcnim, që ka për pasojë ose sigurisht që do ta ketë si pasojë të padrejtën fizike, psikologjike dhe emotive.¹³ Dhuna seksuale është formë e dhunës, që bazohet në përkatësinë gjinore. UNHCR-i e shfrytëzon nocionin gjithëpërfshirës dhuna seksuale dhe dhuna në bazë të përkatësisë gjinore, duke marrë parasysh faktin se djemt, si dhe meshkujt e rritur, mund të jenë viktimë e dhunës seksuale dhe e dhunës mbi përkatësinë gjinore, edhe pse gratë dhe fëmijë përbëjnë numrin më të madh të viktimave të mbijetuarëve. Dhuna e bazuar mbi përkatësinë gjinore është dhunë e drejtuar kundër ndonjë individi, si rrjedhim i përkatësisë gjinore ose gjinisë gjenetike.¹⁴

Kjo nënkupton veprimet, të cilat shkaktojnë padrejtësi dhe vuajtje fizike, shpirtërore ose seksuale, klërcnim, detyrim dhe forma të tjera të privimit nga liria... Deri sa gratë, burrat, djemt

¹³ Dhuna e bazuar në përkatësinë gjinore është definuar nga ana e Këshillit CEDAW, si dhunë e drejtuar kah individi ose grupe individësh, në bazë të përkatësisë së tyre gjinore ose gjinisë së tyre gjenetike. Këtu përfshihen edhe veprat që shkaktojnë padrejtësi apo vuajtje fizike, shpirtërore ose seksuale, kërcnim, detyrime ose forma tjera të privimit nga liria.

¹⁴ Definicioni i zgjeruar i dhunës seksuale dhe dhunës mbi baza gjinore, me të cilin shërbehet UNHCR-i dhe partnerët e tij ekzekutivë (bazuar në nenet 1 dhe 2 të Deklaratës së Asamblesë së Përgjithshme të KB mbi Eliminimin e dhunës ndaj femrave (1993) dhe Rekomandimin 19, paragrafi 6, nga mbledhja e 11 e Këshillit CEDAW) ...

dhe vajzat mund të jenë viktimë e dhunës seksuale, bazuar në përkatësinë gjinore, gratë dhe vajzat janë viktimë më e shpesht e kësaj dhune. ... do të përfshijë, por jo edhe të jetë e kufizuar si vijon:

a) Dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike brenda familjes, duke përfshirë këtu rrahjen, shfrytëzimin seksual, keqtrajtimin seksual të fëmijve në familje, dhuna që lidhet me miraz, përdhunimin në martesë, lëndimin e organe gjenitale të femrës si dhe zakonet e tjera tradicionale që e dëmtojnë femrën, dhuna nga pala tjetër që nuk është bashkëshort dhe dhuna që lidhet me shfrytëzimin.

b) Dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike në rrethin e gjerë të bashkësisë, përfshirë këtu përdhunimin, keqtrajtimin seksual, sulmin seksual dhe frikën në vendin e punës, në institucionet arsimore dhe vendet e tjera, trafikun me femra dhe prostitucionin.

c) Dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike e kryer apo e pranuar heshtazi nga ana e shtetit dhe institucionet e tij, pa marrë parasysh se ku ka ngjarë ajo. Dhuna seksuale dhe dhuna mbi bazë të përkatësisë gjinore më së tepërmi është rrënjësore në marrëdhëniet e pabarabarta të forcës ndërmjet gjinive. Këto marrëdhënie ia zgjatin jetën dhunës brenda familjes, bashkësisë dhe shtetit, duke e pranuar në heshtje.

Dallimi ndërmjet sferave publike dhe private, nuk duhet të shërbejë si preteks për injorimin e problemit të dhunës në familje, si formë e dhunës seksuale dhe dhunës së bazuar në përkatësinë gjinore. Përjashtimi i grave dhe i vajzave nga jeta publike, vetëm sa e shton nënshtrimin e tyre për dhunë brenda familjes. Dhuna brenda familjes e shton diskriminimin, bazuar në përkatësinë gjinore, duke i mbajtur femrat në një pozitë nënshtruese, në krahasim me meshkujt.

Në disa kontekste juridike të caktuara, termi *viktimë* është i përshtatshëm ose i obligueshëm, për shkak të ligjeve relevante, në rastet kur kërkohet dëshpërbim përmes drejtësisë. Ndërsa, në situata jojuridike, fjala viktimë, mundet të marrë kuptimin e personit të paaftë dhe të njollosur, por një përshkrim të tillë të vetive të karakterit, duhet flakur nga të gjithë ata që merren me këtë tematikë. Por, për ta kuptuar më mirë këtë gjëendje faktike, në këtë punim, do të përdorën që të dy termet. Edhe pse burrat dhe djemt, shpeshëherë janë viktimë

persona që e kanë mbijetuar dhunën seksuale, statistikat vërtetojnë se gratë dhe vajzat janë më shpesh viktimat persona të mbijetuar.¹⁵

4.4. Dhuna ekonomike

Dhuna ekonomike, ka të bëjë me kontrollin e partnerit mbi të ardhurat financiare të familjes apo edhe ndalimin e pjesëmarrjes së gruas në vendimet për shpenzimet e parave, madje edhe refuzimi i dhënies së parave për të mbuluar nevojat bazë të familjes, mohimi i pronësisë mbi pasurinë e përbashkët, dëmtim ose shkatërrim të pasurisë, vjedhje të pasurisë, etj.

Abuzim ose dhunë ekonomike, me çdo veprim kufizon ose pengon në menaxhim me të hyrat personale dhe mjetet financiare, për mirëmbajtje të ekonomisë së përbashkët familjare dhe për kujdes të fëmijës, kërkim i llogarisë për paratë e shpenzuara, mos lejimi i punësimit të viktimës, me çka varësi ekonomike e viktimës, shkaktohet. Abuzim ose dhunë psikike, me çdo veprim shkakton ndjenjë të frikës, rrezikimit, shqetësimit ose cenimit të dinjitetit dhe integritetit të viktimës duke e kritikuar, fyer; Përgjim, është kërcënim i qëllimshëm i përsëritur ndaj viktimës, që shkakton që ajo të frikësohet për sigurinë e vet; Trembja, abuzuesi ose dhunuesi përdor mimikë apo fjalë, fyerje të tilla që e bën viktimën të ketë frikë thyen objekte të ndryshme në shtëpi deri tek përdorimi i mjeteve të forta si thika për të trembur viktimën duke e kërcënuar.¹⁶

¹⁵ Termi viktimë nënkupton personat që kanë mbijetuar *dhunën seksuale* i takon individëve ose grupeve që e kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe dhunën e bazuar mbi përkatësinë gjinore. Deri sa ndaj refugjatëve, në çdo rast, duhet sjellur me dhimbësuri dhe ndjenja, sjellja ndaj tyre sikur ndaj të mbijeturëve, do të thotë pranim i forcës dhe qëndrueshmërisë së tyre. Megjithatë, ndodhë që viktimat e dhunës seksuale dhe e dhunës mbi baza gjinore mbetet viktimë, krahas përpjekjeve personale dhe përkrahjes nga jashtë.

¹⁶ Në Policinë rajonale të Ferizajt për 9 muajt e parë të këtij viti janë raportuar rreth 140 raste të dhunës në familje ndërsa në përgjithësi konsiderohet se është rritur vetëdijësimi i popullatës për të raportuar rastet në organet e sigurisë, prandaj ka një numër kaq të madh të rasteve të dhunës në familje. Për të parandaluar përhapjen e mëtutjeshme dhe sensibilizimin e opinionit se dhuna në familje dënohet, policia rajonale e Ferizajt, bashkë me institucionet e tjera lokale, ka hapur sot fushatën me moton “Respekto familjen për t’u respektuar”. Refki Morina, udhëheqës i hetimeve në Policinë rajonale të Ferizajt, thotë se kjo dukuri duhet të raportohet gjithmonë për të mos u mbajtur të izoluar rastet. Sipas një komunikate të Ferizajt, edhe përfaqësues të qeverisë lokale të Ferizajt në hapje të kësaj fushate thanë se dhuna në familje shpesh riprodhon dhunë prandaj duhet shtuar kujdesi që ligjet në fuqi të zbatohen për dhunuesit në mënyrë që të ketë sa më pak raste të tilla në familjet ferizajase. Naim Ferati, nënkryetar i komunës, i cili udhëheq edhe trupën koordinuese kundër dhunës në familje deklaroi se një mobilizim më i mirë i të gjitha institucioneve është mjaft i nevojshëm.

Dhuna online nënkupton përdorimin e internetit për të kërcënuar, ngacmuar, apo poshtëruar një fëmijë duke dërguar mesazhe me përmbajtje jo të përshatshme, email, fotografi dhe video tronditëse tek fëmijët. Interneti është një shesh lojërash i ri dhe është gjithmonë i hapur. Nxënësit me njohuri të përdorimit të internetit tani shfrytëzojnë atë për të ngacmuar shokët e tyre duke përdorur një metodë të re ngacmimi Sajberdhunën, i cili bëhet me paramendim dhe shkakton dëm të përsëritur (dmth. ngacmime, poshtërime, apo kërcënime me tekst ose fotografi) që shkaktohen nëpërmjet internetit, teknologjive interaktive ose telefonave mobil. Fëmijët që janë viktimë e sajberdhunës nuk kanë nga të ikin. Fëmijët mund të ngacmohen në çdo kohë, kudo.

Sajberdhuna po ashtu mund të shkaktohet edhe aksidentalisht. Për shkak të natyrës së komunikimit online për shumë mesazhe apo e-maila është vështirë të përcaktohet toni i dërguesit, shakaja e një personi mund të jetë ofendim i rëndë për një person tjetër. Megjithatë, dërgimi i njëpasnjëshëm i e-mailiave, mesazheve, dhe postimeve të ndryshme rrallëherë është i paqëllimshëm.¹⁷

¹⁷ Afërdita Deva-Zuna e bashkautorët, Partneriteti Shkollë-Familje-Komunitet, faq. 395. Prishtinë, 2009.

KAPITULLI DYTË

DHUNA NË FAMILJE PROFILI I VIKTIMAVE NGA DHUNA NË FAMILJE

„Respekto familjen për t’u respektuar.”¹⁸

1. Përkufizimi i viktimave të dhunës së familje

Analizuar në prizmin e përkufizimit të viktimave të dhunës në familje në bazë të pasojave që u shkaktohen viktimave s’i dhe pasojat që traumatizojnë viktimën nga ushtrimi i dhunës në literaturën e shfletuar dhe në bazën juridiko-shkencore në vijim do të japim disa përkufizime. Viktima në rastet e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare, janë personat mbi të cilët është ushtruar dhunë me veprim apo mosveprim nga një person tjetër, që ka sjellë si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik. *Dhunues/e* në rastet e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, përpara organeve kompetente.¹⁹ *Viktimë e ndjeshme* konsiderohet një fëmijë, një person me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, një person që vuan nga aftësia e zvogëluar, një grua shtatzënë, dhe një partner familjar.²⁰

Një partner familjar është nxjerrë nga përkufizimi i marrëdhënies familjare të përcaktuar si një marrëdhënie ndërmjet dy personave: që janë të fejuar apo të martuar apo janë në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezë, xhaxhallarët dhe dajallarët ose kushërinjtë; ose janë prindër të një fëmije të përbashkët.²¹

¹⁸ Për të parandaluar përhapjen e mëtutjeshme dhe sensibilizimin e opinionit se dhuna në familje dënohet, policia rajonale e Ferizajt, bashkë me institucionet e tjera lokale, ka hapur sot fushatën me moton “Respekto familjen për t’u respektuar”. Refki Morina, udhëheqës i hetimeve në Policinë rajonale të Ferizajt,

¹⁹ Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Neni 1.

²⁰ (KPK neni 120 paragrafi 37).

²¹ (KPK neni 120 paragrafi 23).

Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, herë të përceptuara si sjellje normale dhe herë si të patolerueshme, renditen në të vërtetë ndër shkaqet kryesore të dëmtimit të jetës njerëzore dhe klasifikohen si shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Jetojmë në një shoqëri, ku pavarësisht ndryshimeve pozitive dhe përparimit të arritur, sjelljet stereotipike dhe modelet që nxisin veprime të dhunshme nuk mungojnë në përditshmërinë tone. Të diskutuara si problem mbarëbotëror, një sërë veprimesh për trajtimin e tyre marrin përmasa kombëtare, rajonale dhe botërore.

Për këtë arsye shtetet inkurajohen vazhdimisht të ndërmarrin masat e nevojshme për njohjen, trajtimin dhe menaxhimin me efektivitet të të gjitha rasteve që raportojnë incidente të dhunës në familje, duke ofruar siguri të menjëhershme, mbrojtje, shërbime të standardizuara dhe cilësore për shpëtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të gjithë personave që pësojnë dhunë në familje, pavarësisht moshës, gjinisë, aftësive apo çdo tipari tjetër individual.²²

Shikuar në këtë prizëm, mund të vlerësojmë se institucionet e shtetit duhet të jenë më vigjilent ndaj abuzimeve dhe dhunës në familje për të mbrojtur dinjitetin dhe liritë e të drejtave të të grave dhe njeriut me ligjet pozitive të Republikës së Kosovës dhe konventave ndërkombëtare.

2. Të drejtat e viktimave të dhunës në familje

Dhuna në familje klasifikohet si *shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut* për trajtimin e së cilës ndërmerren përpjekje të vazhdueshme edhe në nivel ndërkombëtar. E përhapur në mbarë botën, në trajta dhe përmasa nga më të ndryshmet dhe e ushqyer nga zakone dhe tradita patriarkale të dominimit dhe kontrollit, shpesh përbën edhe shkakun kryesor të dëmtimeve deri edhe të humbjeve të jetës njerëzore. Për këtë arsye shtetet inkurajohen vazhdimisht të marrin masat e nevojshme për njohjen, trajtimin dhe menaxhimin me efektivitet, të të gjitha rasteve që raportojnë incidente të dhunës në familje, duke ofruar siguri të menjëhershme, mbrojtje, shërbime të standardizuara dhe cilësore për shpëtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të gjithë personave që pësojnë dhunë në familje, pavarësisht moshës, gjinisë, aftësive apo çdo tipari tjetër individual.

²² Ligji nr.03/L-182 i cili në thelb u nxorr nga dispozitat në Rregulloren e mëparshme të UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje.

Në Republikën e Kosovës është themeluar Fondi për Kompensimin e Viktimës është një fond që duhet të përdoret për të kompensuar viktimat e krimit në mënyrë financiare dhe duhet të ngrihet nga dorëzanitë e humbura dhe pasuritë e tjera të autorizuar të depozituara sipas Ligjit. Në qershor të vitit 2015 është miratuar Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit i cili ka paraparë skemën e kompensimit nga shteti për disa kategori të viktimave, ku mes tjerash janë përfshirë edhe viktimat e dhunës në familje.

Mbrojtësi i Viktimës Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave gjendet në Zyrën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës. Mbrojtësi i Viktimës zakonisht takohet me viktimën menjëherë pas reagimit të policisë ndaj një rasti të lajmëruar të dhunës në familje dhe ka përgjegjësi që të sigurojë që viktimat i kupton shërbimet që mund t'i ofrohen nga shteti dhe si mund t'i pranojë ato²³. Me mandatin e ri, sipas Kodit Penal të vitit 2013 dhe Kodit të Procedurës Penale, Mbrojtësi i Viktimës ka një rol të përmirësuar në përfaqësimin e interesave të viktimave duke kërkuar në emër të tyre mbrojtje të drejtave.²⁴

Në mungesë të dokumentacionit përkatës për kategorinë e viktimave të dhunës, si bazë e kërkesës merret deklarata me shkrim e Mbrojtësit të Viktimës²⁵. Pesë zyra për ndihmë juridike, të cilat financohen nga shteti funksionojnë në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjiilan. Institucioni i Avokatit të Popullit është përgjegjës për adresimin e akuzave për shkelje të drejtave të njeriut nga ana e shtetit. Prandaj, në rast se ndonjë institucion i Kosovës, gjatë adresimit të ndonjë rasti të dhunës në familje e keqtrajton viktimën e dhunës kjo e fundit ka të drejtë ta raportojë rastin te Avokati i Popullit për hetim dhe ndihmë. Avokati i Popullit ka zyra rajonale në Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Gjiilan dhe Graçanicë. Zyrat rajonale kanë një njësi për Barazinë Gjimore dhe një Zyrtar për Barazinë Gjimore.

3. Cilat janë subjektet që mbrohen nga ligji për dhunën në familje ?

Llojet e masave që lëshohen në aspektin procedural dhe organizativ të organeve përkatëse institucionale në bazë të legjislacionit të Republikës së Kosovës që ushtrojnë prevencion me

²³ Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familjenë Kosovë, faq 22.

²⁴ ZMNJ-ja ka një numër telefonik publik falas për personat që raportojnë dhe/ose marrin ndihmë lidhur me dhunën në familje: 0800 11 112. Operatori telefonik është i disponueshëm 24 orë në ditë, çdo ditë jave.

²⁵ 9Ligji për Ndihmë Juridike Falas, neni 31 paragrafi 4

qëllim mbrojtje ndaj dhunës së familje janë tri llojet e urdhërave të mbrojtjes që përcaktohen në përputhje me autoritetin e organit që e lëshon urdhërin për mbrojtje, përmbajtjen dhe procedurat që duhet të ndiqen. Kjo përfshin llojet e masave që mund të lëshohen me urdhërat e mbrojtjes. Ligji përcakton Urdhërin për Mbrojtje, Urdhërin për Mbrojtjen Emergjente dhe Urdhërin e Mbrojtjes së Përkohshme Emergjente²⁶.

Siç është paraparë në Ligjin e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje janë hartuar dhe miratuar dy akte nënligjore me qëllim të trajtimit të nevojave të kryesve të veprave të dhunës në familje: Udhëzimi Administrativ nr.12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psiko-social të kryesit të dhunës në familje²⁷ dhe Udhëzimi Administrativ nr. 02/2013 për mënyrën e trajtimit të kryesve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa e mbrojtjes e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotropike²⁸. Këto akte nënligjore përqendrohen vetëm në nevojën për kryesit e varur nga alkooli dhe droga që të trajtohen nga shteti duke identifikuar alkoolin dhe drogën si shkaqe të mundshme të akteve të dhunës në familje. Aktet nënligjore lejojnë krijimin dhe licencimin e OJQ-ve dhe agjencive qeveritare përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për të ofruar trajtime të detyrueshme të urdhëruara nga gjykatat.

Parë në këndvështrimin e subjekteve mbrojtëse dhe atë procedural e organizativ të legjislacionit të Republikës së Kosovës mund të japim konkludimin se të gjitha subjektet institucionale e shtetërore të lartpërmendura kanë për synim dhe qëllim primar parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si në regjionin e Ferizajit ashtu edhe në nivel shtetëror.

3.1. Në shumicën e rasteve, viktimat janë gra dhe fëmijë

Në bazë të dhënave zyrtare shtetërore dhe studimit të këtij punimi mund të konstatojmë se në shumicën e rasteve të dhunës në familje viktimat janë gra dhe fëmijë. Në vijim kemi

²⁶ Nenet 17 dhe 22 të Ligjit Nr.03/L-182

²⁷ Miratuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës në vitin 2012

²⁸ Miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2013.

përzgjedhur disa studime praktike që dëshmojnë dhe arsyetojnë këtë studim për dhunën në familje dhe pasojat e familjes në shoqëri.

Dhuna ndaj grave. Sipas studimit të kryer nga Rrjeti i Grupeve të Grave: “Në Kosovë, gratë statistikisht kanë më shumë gjasa sesa burrat që të vuajnë të gjitha format e dhunës në familje, duke përfshirë edhe dhunën psikologjike, ekonomike dhe fizike, 26 përqind e të gjitha grave të anketuara thanë se në vitin 2014 kanë vuajtur nga dhuna në familje, krahasuar me vetëm 9.7 për qind të burrave të anketuar.²⁹ Në mënyrë të qartë, gratë janë më shumë të rrezikuara nga dhuna në familje sesa burrat³⁰

Dhuna ndaj fëmijëve. Siç u theksua edhe më sipër, përveç dhunës së ushtruar ndaj grave dhe të moshuarve në familje, edhe fëmijët si vajzat ashtu edhe djemtë janë shpesh viktimë të dhunës në familje. Mbi ta mund të ushtrohet dhunë e drejtpërdrejtë fizike, por edhe forma të tjera të dhunës psikologjike, seksuale, ekonomike. Lënia pas dore e fëmijëve është gjithashtu një formë e dhunës që ushtrohet në familje e që në mjaft raste nuk njihet apo perceptohet si e tillë nga shumë prindër e profesionistë.

Dhuna ndaj fëmijëve mbetet një nga fenomenet shqetësuese për shoqërinë bashkëkohore dhe familjet në Republikën e Kosovës ku bënë pjesë edhe rrethi i Ferizajit. Me emancipimin e shoqërisë dhe jeta organizative e familjes jo tradicionale ka ndikuar edhe paraqitjen e dhunës ndaj fëmijëve posaçërisht nga ata prindër që janë rritur në familje të dhunshme që reflekton edhe për gjeneratat e reja.

Kurse lënia pas dore mund të ushtrohet edhe tek fëmijët që jetojnë në familje të pasura, me situatë ekonomike shumë të mirë, me prindër të arsimuar, etj. Ndërkohë, edhe nëse dhuna nuk ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë tek fëmijët, të qenit të pranishëm apo siç cilësohet edhe në Konventën e Stambollit “të qenit dëshmitar i dhunës” në një incident dhune, është provuar se ka ndikim shumë të madh dhe lë pasojë shpesh të papërmirësueshme në jetën e fëmijëve.

²⁹ Raporti mbi Vlerësimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje”, përgatitur nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje me mbështetjen e Zyrës në Kosovë të UN Women-it (autore: A. Qosaj-Mustafaj) Prishtinë. 2014.

³⁰ Sipas „Raportit mbi Vlerësimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje”, përgatitur nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje me mbështetjen e Zyrës në Kosovë të UN Women-it (autore: A. Qosaj-Mustafaj): “...Nga 21 ministri të Qeverisë së Kosovës, vetëm dy ministri udhëhiqen nga gratë, ku njëra është e caktuar si ministre pa portofol. Përmirësime të vogla janë arritur me kuotën për gratë në Kuvend që garantohet me ligjet për zgjedhje, përndryshe Kosova do të vazhdonte të ballafaqohej me sfida të mëdha në përfaqësimin e grave në sferën publike po të mos kishte garanci të ofruara përmes kuotave...”.

Në lidhje me situatën dhe dhunën që pësojnë fëmijët në familje në Kosovë, të dhënat nga studimi i Rr GGK60 tregojnë se 32.6% e kosovarëve pajtohen se “nganjëherë fëmija duhet të dënohet me shuplakë” që sugjeron se goditja fizike me shuplaka ndoshta ende ekziston në një të tretën e familjeve si një formë e disiplinës.³¹ Te kjo kategori e familjeve akoma mbetet edukimi tradicional që bie në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve dhe organizimit familjar, në shoqërinë bashkëkohore.

4. Masat mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje

Masat mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje janë të karakterit urgjent dhe shpresëdhënëse si për viktimat ashtu edhe për pengimin e dhunuesve ndaj antarëve të familjes dhe më gjërë që t’u pengohen mundësitë për abuzime dhe vepra të tilla agresive ndaj personave me më pak fuqi për mbrojtje nga dhuna. Mbështetja nëpërmjet ndjekjes ligjore përfshin sigurimin për viktimat, veçanërisht të këshilluesve të trajnuar për dhunën në familje apo lloje të tjera shërbimesh mbështetëse ose referuese që mund të ndihmojnë dhe mbështesin viktimat gjatë hetimit dhe procesit gjyqësor. Ky lloj shërbimi nuk është i natyrës ligjore por është i natyrës praktike e psikologjike. Ai përfshin përgatitjen psikologjike e emocionale të viktimave për të përballuar dëshminë përpara të akuzuarit, shoqërimin e viktimave në gjykatë, ose ndihmën e tyre në çfarëdolloj mënyre tjetër praktike dhe emocionale.³²

Dështimi për të raportuar abuzimin e fëmijëve ose të dhunës në familje është vepër penale dhe kushdo që nuk i raporton veprat penale, që ndodhin brenda një marrëdhënieje në familje, mund të ndiqet penalisht. KPK-ja parasheh ndjekje *ex-officio sipas detyrës zyrtare* të krimeve të lëndimeve të lehta trupore, lëndim i rëndë trupor, kushte të ngjashme me skllavërinë, puna e detyruar, përdhunimi dhe sulmi seksual kur kryhet në marrëdhënie familjare.

Megjithatë në Kodin Penal nuk përfshihen të gjitha aktet e dhunës në familje të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

³¹ Po sipas studimit të lartëpërmendur: “...Në vitin 2015, gati dy herë më shumë gra (41.7 për qind), sesa burra (23.2 për qind) pajtohen se fëmijët duhet të goditen me shuplakë. Përndryshe, 81.1 për qind e konsiderojnë goditjen e fëmijëve me shuplakë një formë të dhunës në familje dhe 89.6 për qind besojnë se goditja e një fëmije me rrip ose shkop është një formë e dhunës. Përkitazi me metodat e ndryshme të disiplinimit të fëmijëve, në bazë të gjinisë së fëmijës, 36.7 për qind e kosovarëve (37.5 ër qind e grave dhe 35.9 për wind e burrave) pajtohen se “djemtë duhet të kenë disiplinë më të rreptë sesa vajzat, sepse kjo i bën ata të fortë”.

³² Raporti Shjegues që shoqëron Konventën, paragrafi 282

detyron subjektet publike të raportojnë krimet që duhet të ndiqen sipas detyrës zyrtare. Në nenin 63 paragrafin 2 të tij, theksohet rritja e rolit të Mbrojtësit të Viktimave për të përfaqësuar të gjitha viktimat e krimit. Megjithatë, me Kodin e ri pala e dëmtuar ose viktima konsiderohen të njëjtë, të përkufizuar si “personi të drejtat personale apo të pronësisë të të cilit janë shkelur apo rrezikuar nga një veprë penale”. Rritja e rolit të Mbrojtësit të Viktimave gjithashtu parasheh të drejtën e kërimit, në emër të viktimës, të sqarimeve për dëmet dhe shumën e kompensimit të kërkuar me anë të parashtrimit të një deklarate të thjeshtë mbi dëmet. Dëmet e pretenduara mund të jenë fizike, financiare, emocionale dhe mund të përmendin ndonjë rrethanë të ndryshuar të jetës.³³

Si mud të zbulohet dhuna në një familje ? Dhunën në familje e ke përjetuar nëqoftëse: ndonjëherë ke qenë e detyruar fizikisht të veprosh kundër dëshirës dhe vullnetit tënd ose ke qenë e keqtrajtuar apo e ofenduar; të kanë rënë me shuplakë, me grusht, ke qenë e shtyer, e grithur, e ndukur, të kanë rënë me ndonjë send ose mjet, e qëlluar me armë, e shpuar me thikë apo nëse psikikisht dikush të ka ofenduar; të kanë detyruar të bësh marrëdhënie seksuale ose ndonjë veprim tjetër seksual pa dëshirën tënde; ke frikë të takohesh me miqtë ose me anëtarët e familjes se mund të hidhërohet partneri yt ose nëse ke qenë e fyer nga partneri për arsye se takohesh me miqtë apo me anëtarët e tjerë të familjes; kjo ka ndodhur prej kur je në këtë lidhje ose mundet je psikikisht e ofenduar.

Mbështetur në analizimin dhe përjetimin e dhunës në familje, posaçërisht dhunën psikike dhe dhunën fizike e shkaqet që sjellin prishjen e reporteve të antarëve të familjes, mund të kokludojmë se këto pasoja nuk janë aq të thjeshta sa duken në bazë të gjykimit, por ka edhe diçka shpirtërore që krijon sjelljen dhe përshtypjen për veten duke vëzhguar sjelljen e agresorit dhe viktimës e cila pjesë është më e rëndësishme në interpretin dhe veprim ndërfamiljar që është vështirë për t’u hetuar dhe gjykuar nga institucionet përkatëse, prandaj ngelet akoma më shumë për ta studiuar këtë devijim dhe agresivitet mes antarëve të familjes që të prevenohet në kohën dhe momentin e duhur.³⁴

³³ “Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës”, Jon Smibert, Ambasada Amerikanë në Prishtinë, 2013.

³⁴ Duke filluar nga viti 2010, rifunksionalizimi i kësaj linje është mbështetur nga OSBE-ja. Në të ardhmen sugjerohet që t’i lihet më shumë hapësirë funksionimit të kësaj linje bazuar edhe në përshkrimin e rolit të linjës ndihmëse sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtësit e Viktimave. Zyrat për Ndihmë Juridike u ofrojnë mjete juridike grupeve të rrezikuara të mbuluara nga asistencë sociale. Në vitin 2012 Ligji i Kosovës për Ndihmë Juridike Falas i ka përfshirë edhe viktimat e dhunës në familje në listën e kategorive të personave që kanë të drejtë të

KAPITULLI I TRETË

DHUNA NË FAMILJE ME VËSHTRIME TË POSAÇME, KEQTRAJTIMI I FËMIJËVE NË RRETHINËN E FERIZAJIT PËR PERIUDHË 2014-2020

1. Njohuri themelore

Dhuna në familje me vështirime të posaçme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020 përbënë themelsinë e këtij studimi me theks të veçantë abuzimi ndaj fëmijëve dhe të rinjve në Regjionin e Ferizajit. Sa më shumë që mësojmë mbi pasojat që le dhuna tek fëmijët, aq më të qartë bëhen masat që duhen adresuar. Si për periudhën afatshkurtër dhe atë afatgjatë, ekspozimi ndaj dhunës gjatë fëmijërisë ka pasoja jashtëzakonisht negative si për shëndetin mendor dhe atë mendor. Provat sugjerojnë se e gjithë shoqëria mund të dëmtohet nëse një fëmijë vuan në këtë formë. Përkatësisht, ky problem duhet të trajtohet si problem ekonomik dhe shoqëror por edhe të karakterit moral. Duhet pranuar se dhuna ndaj fëmijëve ndodh gjithandej dhe krijon pesimisëm për fundin që mund të sjellë. Raportet e shteteve tregojnë se dhe fëmijët nga vendet e pasura dhe ato të zhvilluara mund të vuajnë nga dhuna. Megjithatë, masa mund të merren për të parandaluar dhunën ndaj fëmijëve dhe për këtë arsye asnjëherë nuk duhet të mendohet për të pashmangshmen. Mirëpo siguria e fëmijës nënkupton edhe mbrojtjen nga abuzimi emocional, fizik, seksual dhe neglizhenca. Siguria është me rëndësi për mirëqenien e fëmijës dhe zhvillimin në aspektin fizik e emocional, sikurse është me rëndësi shëndeti, edukimi, përkujdesja, plotësimi i nevojave themelore, pjesëmarrja apo përfshirja në jetën sociale.³⁵

2. Dhuna ndaj fëmijëve në familje pas luftës në Kosovë

Dhuna ndaj fëmijëve në familje pas luftës në Kosovë mori përmasa më të larta në krahasim me situatën para luftës. Shikuar në këtë prizëm, jo vetëm pasojat e paraqitjes së

nisin procedura për të kërkuar ndihmë juridike falas (neni 31). Në këtë kuptim, roli i zyrtarëve për ndihmë juridike është i ndryshëm nga ai i Mbrojtësve të Viktimave, të cilët menaxhojnë të gjitha rastet e krimeve.

³⁵ Qasja në informacion, botëkuptimet apo pikëpamjet e të rriturve për rritjen e fëmijës, ndikojnë në qasjen e tyre ndaj fëmijëve dhe rrjedhimisht në zhvillimin e fëmijës. Nga pikëpamja profesionale, do të sjellim disa përkufizime dhe shpjegime që mund të shërbejnë për të informuar prindërit ose kujdestarët mbi konceptin e abuzimit, format, pasojat dhe ndikimin e tij në jetën dhe zhvillimin e fëmijës.

vështirësive ekonomike që ndikuan në varfërinë e skajshme të shtetasve të Republikë së Kosovës por edhe pasojat që la lufta në aspektin e depresionit dhe humbjes së shumë familjarve dhe të afërmeve të familjeve në Kosovë. Shumë fëmijë ngelen pa prindër ose me një prindër, pasojë e cila reflektonte edhe sot e kësaj dite kur bëhet fjalë për keqtrajtimin e fëmijëve dhe të rinjve në aspektin e abuzimeve familjare. Këtu mund të shprehem se edhe rrehina e Ferizajit e ka të njetën situatë, po ashtu edhe varfëria dhe gjendja e rëndë ekonomike përbënë një nga faktorët e paraqitjes së dhunës ndaj fëmijëve në rrehtin e Ferizajit. Këtë studim mund ta materializojmë edhe me raportimin e Policisë së Republikë së Kosovës dhe të dhënave statistikore që e argumentojnë hipotezat e këtij studimi shkencor,,

Ligji për mbrojtjen e fëmijës i miratuar këtë vit e dënon çdo formë të dhunës dhe keqtrajtimit të fëmijëve, thotë drejtoresha e KOMF, “ ligji parasheh që Qendrat për Punë Sociale dhe Policia të ndërhyjnë në familje, në bazë të referimit apo në raste kur ekziston dyshimi i bazuar se familja nuk është në gjendje që të mbrojë fëmijën nga rreziku për jetë, dhuna, neglizhimi, keqtrajtimi, abuzimi dhe shfrytëzimi”.³⁶

Në jetën e përditshme qenia njerëzore duhet të zgjidh një varg problemesh që lidhen me jetën e përditshme, fatkeqësisht një grup njerëzish këto problem i zgjedhin në bazë të dhunës ku lirshëm e ushtrojnë ndaj antarëve të tyre të familjes , sepse edhe vet çështjet problematike krijohen në këto raporte ose marrëdhënie prind fëmijë që në të shumtën e rasteve prindët nuk mund t'i plotësojnë detyrimet e përgjithshme dhe rezultojnë në dhunë ndaj fëmijëve ose anëtarëve të tjerë të familjes.

Parë në këtë prizëm, e argumentojmë edhe me udhëzimet që jep Avokati i Popullit, në opinionin lidhur me ndikimin e dhunës në shëndetin dhe jetën sociale të fëmijëve si dhe masat që duhet ndërmarrë nga institucionet përgjegjëse, ka rekomanduar që trajtimi i dhunës ndaj fëmijëve të marrë përkushtim dhe angazhim të vazhdueshëm, në rend të parë nga institucionet shtetërore, të cilat janë të obliguara ta bëjnë këtë në pajtim me legjislacionin. Poashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar të zbatohen masat dhe planet konkrete për adresimin adekuat të këtij fenomeni.

Parë në këtë prizëm, mund të vlerësojmë se dhuna dhe abuzimi me të drejtat e fëmijëve është në rritje e sipër nga edhe vet institucionet e shtetit dhe institucionet ndihmëse administrative e

³⁶ Donjeta Kelmendi. Qendra për mirëqenie sociale Ferizaj 2018.

gjyqësore duhet të krijojnë një strategji të përbashkët për të prevenuar dhe penguar këtë dukuri devijuese në shoqërinë tone.³⁷

3. Format e dhunës ndaj fëmijëve

Njerëzit në jetë përjetojnë edhe shumë ngjarje e peripeci të mbingarkuara emocionalisht, në vargun e tyre bëjnë pjesë situatat që janë të mbushura me tensione e konflikte, të cilat vijnë prej grindjeve, mosmarrëveshjeve e fajësimeve të ndërsjella . zakonisht këto roperte jo racionale përfundojnë në gabime dhe fajësime të ndërsjellta, akuza ndaj njëri tjetrit dhe në të shumtën e rasteve këto raporte përfundojnë në depression dhe dhunë kun ë të shumtën e rasteve viktimat kolaterale janë fëmijët.

Shumica e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve përfshin të paktën një nga gjashtë llojet kryesore të dhunës që mund të ndodhin në faza të ndryshme të zhvillimit të fëmijës.³⁸ *Dhuna emocionale ose psikologjike* përfshin kufizimin e lëvizjeve të fëmijës, denigrimin, përqeshjen, kërcënimet, diskriminimin, refuzimin etj. Kur drejtohet kundër vajzave apo djemve për shkak të seksit të tyre biologjik ose identitetit gjinor, kjo formë dhune konsiderohet dhunë me bazë gjinore. *Bullizmi* është sjellje e padëshiruar agresive nga një fëmijë tjetër ose grup fëmijësh të cilët nuk janë vëllai/motra, dhe as nuk kanë një marrëdhënie intime me viktimën. Bullizmi përfshin dëmtime të përsëritura fizike, psikologjike ose sociale, dhe shpesh ndodh në shkollat dhe mjedise të tjera ku fëmijët mblidhen, ose në internet.

Keqtrajtimi përfshinë dënimin e dhunshëm përfshin dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike/emocionale, neglizhimin e foshnjave, fëmijëve dhe adoleshentëve nga prindërit, kujdestarët etj., më shpesh në shtëpi, por edhe në mjedise të tilla si shkollat dhe jetimoret. *Dhuna nga të rinjtë është e përqendruar ndaj fëmijëve dhe të rinjvetë moshës 10-29 vjeç*. Ndodh shpesh

³⁷ Raportimet te Policia e Kosovës për keqtrajtimin e fëmijëve e shfaqin një trend të qëndrueshëm: në vitin 2017 janë raportuar 243 raste, vitin e kaluar 244, ndërsa këtë vit në periudhën janar – mars janë raportuar 37 raste. Ndërkohë, “Analiza e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, Mjaft më me arsytimit”, e realizuar nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës në vitin 2015, tregon se vetëdijesimi për dhunën fizike në familje është rritur. Studimi ka gjetur se goditja e fëmijëve me shuplakë konsiderohet formë e dhunës në familje nga 81.1 për qind e të anketuarve.

³⁸ Ligji nr. 05/L-025 “Për shëndetin mendor”; dhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020 (SKMDHFPV).

në mjediset e komunitetit mes të njohurve dhe të huajve, dhe përfshin ngacmimet dhe sulmet fizike me ose pa armë (si armë dhe thika), si dhe dhunën e bandave.

Dhuna nga partneri intim përfshin dhunë fizike, seksuale dhe emocionale nga një partner intim ose ish-partner. Edhe pse meshkujt mund të jenë viktimë, dhuna nga partneri intim ndodh më shpesh te femrat.³⁹

Dhuna seksuale- Dhuna seksuale përfshin kontaktet seksuale të përfunduara ose të tentuara me forcë, aktet me natyrë seksuale që nuk përfshijnë kontakt (si prekje pa dëshirë ose ngacmimet seksuale), trafikimin seksual të dikujt që nuk është në gjendje të pranojë ose të refuzojë, si dhe shfrytëzimin nëpërmjet internetit. *Ndikimi i dhunës*-Dhuna ndaj fëmijëve ndikon të mënyrë afatgjatë në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve, familjeve, komuniteteve etj. Dhuna ndaj fëmijëve mund të rezultojë në: *Dëmtim të trurit dhe sistemit nervor. Përballje me sjellje të rrezikshme për shëndetin.* Fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës kanë më shumë gjasa të konsumojnë duhan, të bëhen përdorues të alkoolit dhe drogës, dhe të përfshihen në sjellje seksuale me rrezik të lartë. Studiuesit e emocioneve kanë analizuar të gjitha këto raporte dhe situata për të kuptuar më mirë pasojat dhe shkaqet e dhunës ndaj fëmijëve.

Nëse merret si bazë për preventim ndaj këtij fenomeni, edukimi i mirfilltë dhe projekte të veçanta shkollore janë shumë të domosdoshme për të ngritur vetëdijen tek fëmijët dhe të rinjtë, me qëllim që këto raporte të mos kthehen në një mjet tensionesh e mosmarrëveshjes të vazhduara të cilat në rrjedhim kuptohen si *sulm personal*, sesa si vërrejtje për t'u korrigjuar.

4. Pasojat e dhunës ndaj fëmijëve

Pasojat e dhunës ndaj fëmijëve në situatën e pademisë janë akoma më të komplikuar dhe në rritje e sipër mbështetur në të dhënat zyrtare, ka rëndësi të kuptohet fakti se sa më shumë që lëndohen fëmijët qoftë në aspektin emocional ose përjetim të dhunës në forma të ndryshme që

³⁹Dhuna ndaj fëmijëve mund të parandalohet. Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës te fëmijët kërkon që përpjekjet në mënyrë sistematike të adresojnë rrezikun dhe faktorët mbrojtës në të katër nivelet e ndërlidhura të rrezikut (individ, marrëdhënie, komunitet, shoqëri). Paketa synon të ndihmojë vendet dhe komunitetet të arrijnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) 16.2 për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve.

ushtrohen ndaj tyre, aq më shumë do të ketë rritur që do të jenë potencial për të ushtruar dhunë kur të rriten ndaj anëtarëve të familjes së tyre dhe jashtë sajë.⁴⁰

Shikuar në këtë prizëm, pasojat e dhunës ndaj fëmijëve ka edhe shumë forma dhe mënyra të tjera që na shërbejnë në aspektin shkencor për t'u hulumtuar më me shumë përkushtim me qëllim që të sjellim nga idetë dhe argumentet që janë aktuale në prevencionin kundër dhunës ndaj fëmijëve.

5. Format e dhunës kundrejt fëmijëve kanë pasoja socio-ekonomike

Format e dhunës kundrejt fëmijëve kanë pasoja socio-ekonomike në të gjitha pikëpamjet e dhunës që ushtrohet ndaj fëmijëve dhe të rinjëve. Nga ky këndvështrim të gjitha format e dhunës kundrejt fëmijëve kanë pasoja socio-ekonomike. Si rezultat, kjo kufizon mundësitë e fëmijëve viktimë për të kontribuar në shoqëri dhe kështu lulëzimi dhe mbarëvajtja e gjithë komunitetit preket nga dhuna. Në nivel global, mendohet se ndikimi ekonomik i dhunës fizike, psikologjike dhe seksuale ndaj fëmijëve ka rezultuar në humbje prej 7 triliard dollarë në vit, një shumë thuajse e pa imagjinueshme.⁴¹

Pare në këtë prizëm, mund të vlerësojmë se vetëdijësimi i shoqërisë duhet të formohet nëpërmjet introspeksionit, duke vëzhguar sjelljet tona, duke u krahasuar me të tjerët, duke organizuar më shumë aktivitete të lira si nëpër shkollë ashtu edhe në përmirësimin e komunikimit që të mos jetë agresiv dhe me pasoja depresive, sepse në të shumtën e rasteve komunikimi agresiv çon drejtëpërdrejtë në prishjen e raporteve si ato ndërfamiljare ashtu edhe ndërnjerëzore që në jetën e përditshme shpeherë përfundojnë në dhunë ndaj fëmijëve dhe të rinjëve.

⁴⁰ Prirja për viktimizimin e fëmijëve dëmtinë rëndë ndërgjegjësimin dhe nxitjen e qëndrimeve negative edhe ndaj shoqërisë, prandaj pasojat e dhunës ndaj fëmijëve janë shumë më të rënda dhe të komplikuara për t'u sanuar se sa i shohim në sipërfaqe apo institucionet i detektojnë këto devijime.

⁴¹ Duke marrë parasysh rekomandimet e Studimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Dhunën kundër Fëmijëve, në veçanti për të zhvilluar një kuadër të shumëfishtë dhe sistematik për t'ju përgjigjur dhunës kundër fëmijëve, të integruar në procesin kombëtar të planifikimit nëpërmjet një strategjie, politike ose plani kombëtar, dhe për identifikimin e një pike kontakti, mundësisht në nivel ministror, për mbikëqyrjen e zbatimit të masave për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës.

6. Dhuna në familje në Ferizaj

Vetëreferimi dhe procesi i përcjelljes së dhunës në familje në rrethin e Ferizajit dhe më gjërë jo vetëm që është i pranishëm në familje, por shpeshëher kemi raste kur dhuna në familje përfundon edhe me pasoja të rënda. Konceptimi i këtij fenomeni devijues në komunën e Ferizajit jo vetëm që është në rritje e sipër, por, edhe pak ka studime shkencore në aspektin e njohjes së këtij fenomeni devijues si për nga themelësia e problemit ashtu edhe për nga shkaqet e paraqitjes. Dhuna në familje jo vetëm që ka një përmbajtje emocionale por, edhe atë shpirtërore që shkaktojnë dhunën tek më të afërmit dhe neve na takon që më detalisht të njohim shkaqet e dhunës dhe të njohim edhe pasojat që shkakton kjo dukuri devijuese në shoqërinë tone bashkëkohore.⁴²

Pas periudhës së izolimit nga Covid 19 në komunën e Ferizajit janë regjistruar 23 raste të dhunës në familje ndërmjet çifteve bashkëshortore, në të cilat ka intervenuar edhe Qendra për Punë Sociale. Sipas statistikave të regjistruara në këtë institucion, çiftet që kanë përdorur dhunë ndërmjet vete janë kryesisht të rinj.⁴³ Të gjitha këto raste janë regjistruar pas lirimit të izolimit nga pandemia. Sipas saj, rastet e dhunës janë në rritje, andaj zyrtarët socialë vazhdimisht po intervenojnë në kohë dhe në mënyrë profesionale, duke stabilizuar situatën në shumicën e rasteve. “Këto raste kanë pasur nevojë për shërbime sociale, pra kanë qenë kryesisht raste të reja dhe çifte të reja bashkëshortore. Kjo ka rrjedhë si pasojë e izolimit nga pandemia, andaj është shumë me rëndësi bashkëbisedimi ndërmjet çifteve bashkëshortore, sepse shumica e tyre nuk e kanë “njohur” njëri-tjetrin dhe ky është shkaktari kryesor i “çrregullimeve martesore”.

Nga kjo që përmendëm më lartë mund të konkludojmë se pasojat e pandemisë ndikuan akoma më shumë që këto fenomene jo vetëm që janë në ngritje e sipër por, ka edhe shumë pasoja të tjera që ka prishur mënyrën tradicionale të funksionimit të familjes.

⁴² Në Kosovë, sipas Fondacionit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara, si dhe organizatave të tjera që merren me të drejtat e fëmijëve, thuhet se mbi 60 për qind e fëmijëve deri në moshën 14 vjeç, kanë deklaruar se kanë pësuar dhunë fizike dhe psikologjike nga prindërit dhe familjarët në familje dhe nga mësimdhënësit në shkollë. Përdoruesit e dhunës ndaj fëmijëve harrojnë se fëmijët janë duke u rritur dhe se nga dhuna që ushtrohet mbita nga rrahjet me shuplaka, me grushte, me tërheqje flokësh, meshqelma, me shkop, me rrip, etj, mund të lërë pasojë fizike dhe psikike në fëmijëri, por edhe gjatë jetës së tyre. Efektet negative të dhunës ndaj fëmijëve më së miri i dijnë psikologët, sociologët, pedagogët, mjekët, neuropsikiatrit, etj.

⁴³ Adelina Rexhepi-Braha, udhëheqëse e Shërbimeve Sociale në QPS të Ferizajit, ka thënë për KOHËN.

6.1. Shkaqet e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit

Shkaqet e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit për nga objekti i studimit janë shumë dimesnionale dhe shumë vështirë për të pasur një qasje shkencore. Mirëpo, nëse mbështetemi tek të dhënat zyrtare shembull përmes një komunikate për media është bërë e ditur se gjatë muajit nëntor, Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngritur pesë aktakuza dhe ka caktuar një masë për paraburgim për rastet e dhunës në familje, gjegjësisht për veprat *penale Lëndim i lehtë trupor, Sulm dhe Kanosje*.⁴⁴

Shkaqet e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit janë:

- Shkaqet ekonomike ose varfësisë së skajshme që ndikojnë drejtëpërdrejtë në dhunën familjare.
- Shkaqet individuale ku bëjnë pjesë, qëndrimet, mendimet për dhunën, mangësitë e aftësive të komunikimit mesa antarëve të famiëljes.
- Shkaqet e përdorimit të lëndëve narkotike etj.
- Shkaqet që rrjedhin nga familja; mungesa e dashurisë ndërfamiljare dhe mbështetjes prindërore etj.
- Shkaqet shoqërore që mund të jenë të ndryshme si pabarazia shoqërore e ekonomike, papunësia, tranzicionin i stërgjatur, ndikimi i mjeteve të informimit, situatat e pasluftës në Kosovës, qasjet deri te armët e ndryshme etj.

Shkaqet e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit mbeten shumë dimesnionale dhe shumë vështirë për të pasur qasje shkencore e cila do të argumentonte shkaqet e lartëpërmendura. Kjo na detyron që përpjekjet hulumtuese dhe shkencore të jenë më të pranishme për të mësuar nga terreni gjendjen faktike të dhunës në familje në Komunën e Ferizajit dhe më gjërë.

6.2. Dhuna që ndodh brenda shtëpisë shpesh konsiderohet si çështje private dhe është më pak serioze sesa dhuna që ndodh në publik

Dhuna që ndodh brenda shtëpisë shpesh konsiderohet si çështje private dhe është më pak serioze sesa dhuna që ndodh në publik. Parë në këtë prizëm, mund të vlersëjmë se pa marrë

⁴⁴ Në bazë të dhënave nga Prokuroria Themelore në Ferizaj shprehen se kan ngritur pesë aktakuza dhe kanë caktuar një masë për paraburgim për rastet e dhunës në familje, gjegjësisht për veprat *penale Lëndim i lehtë trupor, Sulm dhe Kanosje* mbështetur në Kodin e Procedurës penale të Republikës së Kosovës.

parasysh se ku kryhet dhuna në hapsira publike apo private pasojat nga ky fenomen janë të njejta dhe me pasoja të rënda për viktimat e dhunës.

Dhuna që ndodh brenda shtëpisë është më komplekse nga ajo publike dhe është shumë e pranueshme në aspektin konceptual dhe atë juridik, mirëpo, në shumicën e rasteve këto veprime ndryshojnë formën e veprimit dhe paraqitja e dhunës në familje has në shumë vështirësi sepse në të shumtën e rasteve ndodh që viktimat edhe pas denoncimit apo procesit gjyqësor të rrikthehet përsëri te familja. Këto veprime institucionale jo vetëm që nuk e ndërpresin këtë devijim por, përkundrazi akoma më shumë inkurajojnë dhunuesin e të drejtave dhe lirive të fëmijëve apo grave që të ndjehet akoma më i fuqishëm.

6.3. Vendimi për të mos e braktisur kryesin shpesh konsiderohet zgjedhje e menduar e viktimës për shkaqe të ndryshme

Vendimi për të mos e braktisur kryesin shpesh konsiderohet zgjedhje e menduar e viktimës për shkaqe të ndryshme. Mitet e shpeshta për dhunën në familje ekzistojnë disa mite e keqkuptime të zakonshme tek popullata në lidhje me dhunën në familje, sidomos për gratë dhe komunitetet e ndryshme, ndërsa mbulimi medial mundet shpesh të mbështesë dhe të nxisë disa prej këtyre miteve.⁴⁵

Duke analizuar situatat e këtilla në këndvështrimin e çrregullimit të gjendjes emocionale mes raporteve dhe marrëdhënieve të anëtarëve të familjes dhe shkaqeve që nxisin dhunën dhe viktimizimin ndaj fëmijëve dhe me rritjen e individit ose fëmijëve në moshë vihet re edhe *periudha rënieje* apo të çrregullimit të gjendjes së përgjithshme individuale tek fëmijët ndonjë rast edhe duke mos i përfillur urdhrat e prindërve apo anëtarëve tjerë të familjes shpeshherë shkakton prishjen e komunikimit që vjen edhe si faktor nxitës për ushtrimin e dhunës nga ana e prindërve të tyre. Për më tepër, kjo i jep arsyetim keqtrajtuesve, që ushtrojnë dhunë në familje qëllimisht duke përdorur pushtetin dhe kontrollin. *Vendimi për të mos e braktisur kryesin shpesh konsiderohet zgjedhje e menduar e viktimës për shkaqe të ndryshme.*

⁴⁵ Kjo është e pasaktë ikja nga mjedisi i dhunës në familje përbën rrezik të madh për viktimën, mund të shpjerë edhe tek humbja e të ardhurave punësimit vendbanimit miqësisë mbështetjes, dhe këto rreziqe rriten edhe më shumë kur viktimat ka fëmijë. Ikja nga ai mjedis mund të sjellë edhe rritje të rrezikut të sulmeve e kërcënimeve të tjera. Vënia e fokusit tek pyetja pse viktimat nuk ka ikur është fajësim i viktimës, si dhe e heq përqendrimin nga veprimet e keqtrajtuesit

Vendimi për të mos e braktisur kryesin shpesh konsiderohet zgjedhje e menduar dhe strategjike e viktimës. Si, shembuj ku sipas bazave të këtilla është e përjashtuar kundërligjsh - mëria mund të theksohen privimi nga liria e personave të këtillë, cenimi i konfidencës së letrave të tyre, marrja e disa sendeve të tyre etj, nëse këto veprime ndërmerren me qëllim të edukimit të fëmijëve.

Të këtilla nuk do të ishin veprimet të kryera në mes bashkëshortëve, veçmas nuk do të mund të thuhej se burri në raport me gruan në atë drejtim ka ndonjë pozitë të veçantë.

Sipas praktikës gjyqësore Franceze, një gjykatë në vitin 1922 e ka liruar personin nga dënimi për arsye se ndaj gruas së tij ka aplikuar dënimet trupore, mirëpo gjykata e kasacionit nuk ka pranuar qëndrimin e këtillë juridik të gjykatës së ulët, duke konsideruar se ajo është në kundërshtim me zakonet bashkëkohore.⁴⁶

Pare në këtë prizëm, mund të vlerësojmë se edukimi i fëmijëve është e drejtë dhe obligim i prindërve, kujdestarit dhe edukatorit. Këto të drejta dhe detyrime bazën e kanë në të drejtën familjare. Gjithashtu, me qëllim të edukimit dhe të arsimimit të fëmijëve dhe në përgjithësi të nxënësve, autorizime të posaçme u njihen edhe mësuesve dhe profesorëve.

Veprimet apo masat e këtyre personave nuk do të konsiderohen veprime të kundërli - gjshme nëse ndërmerren me qëllim të edukimit dhe arsimimit të nxënësve. Nga kjo rezulton se tolerohet lëndimi i ndonjë të drejte me qëllim të realizimit të qëllimit të përgjithshëm të pranuar, i cili në këto situata ka përparësi.

7. Mos paraqitja e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit

⁴⁶ Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute/ 6.10.4 „ Veprat apo masat që ndërmerren në bazë të së drejtës prindërore dhe të drejtës së edukimit,, faq.51. KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Prishtinë, nëntor 2016.

Mos paraqitja e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit përbënë një nga shkaqet e rritjes së rasteve të dhunës në familje dhe motivon kryesin për veprimet e tija të vazhdueshme me abuzimin ku shpesh përfundojnë edhe me fatalitet rastet e dhunës në familje në Komunën e Ferizajit. Kohëve të fundit komuna e ferizajit në bashkëpunim me shumë mekanizma të tjerë nëbashkëveprim kanë arritur që vetëdisimi i viktimave të jetë më i lartë dhe ka më shumë denoncime në raport me vitet paraprake. Po përmendim aktivitetin e komunës së ferizajit,, Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje në komunën e Ferizajit ka mbajtur takimin e parë me qëllim hartimin e politikave dhe realizimin e aktiviteteve për parandalimin e këtij fenomeni negativ mjaft të shprehur në shoqërinë kosovare.⁴⁷ Në këtë takim diskutua për gjendjen me këtë fenomen në Rajonin e Ferizajit si dhe masat që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse në nivel lokal dhe rajonal. Nënkryetari i Komunës së Ferizajit, Naim Ferati, njëherit kryesues i këtij mekanizmi u shpreh se Ferizaj po krijon këtë trupë në nivel regional për të parandaluar një fenomen mjaft të shëmtuar siç është dhuna në familje, fenomen ky që sipas të dhënave nga organet e drejtësisë dhe sigurisë po shënon rritje të vazhdueshme."Ne përmes këtij mekanizmi synojmë që të mirë koordinohemi në masat institucionale kundër këtij fenomeni.

Në anën tjetër, prokurorja nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, Sebahate Sinani u shpreh se ka raste të shumta në këtë drejtim dhe se Prokuroria Themelore e Ferizajit është shumë efikase në trajtimin e tyre.“Vetëm në tremujorin e parë të vitit 2018 kemi pas 28 lëndë, 22 prej të cilave janë përfunduar. Kemi një bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe përpjekja jonë e vazhdueshme është ulja e recidivit, gjegjësisht zvogëlimi i numrit të përsëritësve të këtyre veprave përmes aplikimit të masave ligjore të ndalimit”, tha Sinani.Përfaqësues të Gjykatës Themelore në Ferizaj u shprehën se ka raste të shumta të dhunës në familje, përkatësisht vetëm vitin e kaluar ka pas 98 raste nga Rajoni i Ferizajit dhe afro 50 prej tyre janë vetëm këtë vit.⁴⁸

⁴⁷ Vetëm sipas Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore dhuna me bazë gjinore konsiderohet si formë diskriminimi (neni 4.2 i ligjit). Megjithatë, Kosova ende nuk ka ndonjë përkufizim të dhunës me bazë gjinore në procedurat penale dhe civile. Përkundër kornizës ligjore, e cila mbulon disa akte të dhunës me bazë gjinore, mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës dhe holistik të dhunës me bazë gjinore në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, ndikon ndjekjen efektive dhe dënimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Dhe, edhe pse përkufizimet për dhunim, vrasje, veprime kundër partnerëve të brendshëm dhe disa krime të tjera të dhunës në baza gjinore ekzistojnë në legjislacion, hetimi dhe ndjekja e krimeve të tilla vazhdojnë të karakterizohen me shkallë të ulët të dënimit.

⁴⁸ InfoKomuna, Ferizaj, 2018.

Ka shumë raste që shkaktarët janë përsëritës të këtyre veprave, pra dhunës në familje. Edhe përfaqësuesit e tjerë të sektorit të kujdesit social u shprehën të shqetësuar me numrin e madh të këtyre rasteve dhe sfidave për të përballuar këtë fenomen përmes strehimores që aktualisht është e licencuar për trajtimin e viktimave të dhunës në familje, në territorin e Ferizajt. Për këtë institucion të pranishmit shprehën rezerva sa i përket mirëfunksionimit, mirëpo me koordinimin më të mirë të këtyre institucioneve në këtë mekanizëm të parandalohet ky fenomen. Ky takim ishte i pari i këtij lloji i mbajtur nga Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje, takime këto që do të shpeshtohen me miratimin e agjendës së punës dhe aktiviteteve të kësaj trupe.⁴⁹

Nëse analizohen arsyet e dhunës së shprehur në nivel aq të lartë në shoqërinë tonë, motivi i përbashkët është dhuna e ushtruar sistematikisht, gjeneratë pas gjenerate. Psikologja Ibelinda Halili e sheh dhunën ndaj fëmijëve si pasojë të dhunës që prindërit apo kujdestarët e kanë përjetuar personalisht. “Personat të cilët e shfaqin dhunën në shumicën e rasteve kanë qenë viktimat të dhunës edhe vetë”, thotë ajo. Gjithashtu, ajo thotë se ekzistojnë edhe arsye të tjera pse në shoqërinë tonë dhuna njihet si metodë për zgjidhjen e shumë problemeve, jo vetëm për disiplinimin e fëmijëve.⁵⁰

8. Raste nga praktika në Ferizaj I

Në një rast në Ferizaj, më 20 nëntor 2006, Prokurori Publik Komunal e ka hedhë poshtë kallëzimin penal të policisë të datës 3 nëntor 2006 që tregonte se burri e kishte sulmuar fizikisht gruan e tij dhe i kishte shkaktuar lëndime, si rrjedhim ka kryer vepër penale që duhet të ndiqet sipas detyrës zyrtare *ex officio*. Sipas hetimit të policisë, ka pasur dhunë ndërmjet çiftit edhe para ndodhjes së këtij incidenti.

Në vendimin mbi hedhjen poshtë të kallëzimit, prokurori e ka interpretuar gabimisht legjislacionin aktual në fuqi dhe ka pohuar që të dyja palët kanë kryer dhunë në familje, një

⁴⁹ Pres angazhimin e secilit prej përfaqësuesve të institucioneve në adresimin dhe prioritizimin e këtij fenomeni brenda institucionit ku bën pjesë. Si fazë e parë do të hartojmë një plan pune si dhe agjendën e takimeve dhe aktiviteteve që do të ndërmarrim në mënyrë që kështu të nisim një fushatë të gjerë për vetëdijesimin e qytetarëve kundër këtij fenomeni”, tha nënkryetari Ferati.

⁵⁰ Mitet e zakonshme janë, por nuk kufizohen vetëm në këto: Dhuna në familje është pasojë e abuzimit të substancave, stresit, varfërisë, dështimit në martesë. Kjo është e pasaktë pasi që nënkupton që ata që përjetojnë ndonjërin nga ato që u përmenden më lart ushtrojnë dhunë në familje, gjë që përforcon stereotipat negativë.

vepër penale që nuk ekziston. Veç kësaj, në vendimin mbi hedhjen poshtë të kallëzimit ceket se *vepra penale e dhunës në familje nuk radhitet në mesin e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare ex officio*. Në një rast tjetër në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, më 23 mars 2007 prokurori ka hedhë poshtë një raport policor i cili kishte të bënte me një rrahje të supozuar të fëmijës me shkop nga babai i saj.

9. Raste nga praktika në Ferizaj II

Në vendimin mbi hedhjen poshtë të raportit policor, prokurori pa të drejtë kishte cekur që në veprimet e të pandehurit nuk ka asnjë element të ndonjë vepre penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare. Në rastet e përshkruara më lart, mungesa e raportit mjekësor e bën të vështirë të përcaktohet se a ka mjaft dëshmi për ekzistim të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor. Policia nuk i ka sjellë me kohë prokurorit të gjitha dëshmitë e nevojshme për të bërë ndjekjen e një vepre të mundshme penale. Sidoqoftë edhe prokurori nuk është treguar i kujdesshëm në veprimet hetuese përgatitore duke mos mbledhur të gjitha provat e nevojshme. Si pasojë, personi i cili ka gjasa të ketë qenë i përfshirë në vepër penale nuk është përballur me drejtësinë. Po ashtu, OSBE-ja ka monitoruar raste ku autoritetet kanë lëshuar urdhra për mbrojtje në përputhje me Rregulloren, në vend se të bëjnë hetime dhe kur është nevoja, të ndjekin veprën penale të lëndimit trupor. Në një rast pranë autoriteteve në Pejë, në shkurt të vitit 2007 policia i ka paraqitur organeve të ndjekjes një dosje të incidenteve të dhunës në familje ku një viktimë femër kishte pësuar lëndime të dukshme trupore. Prokuroria publike nuk ka mundur ta gjejë rastin në regjistrin e saj të dosjeve. Si pasojë, prokurori asnjëherë nuk e kishte hetuar apo ndjekur këtë vepër të mundshme penale. Në vend të kësaj, gjykata komunale kishte lëshuar një urdhër për mbrojtje kundër burrit të viktimës.

10. Raste nga praktika në Ferizaj III

Në një rast në vitin 2004, që ishte trajtuar nga autoritetet në Leposaviq, i cili kishte të bënte me dhunën në familje dhe i cili kishte rezultuar me lëndime të dukshme në fytyrën e një gruaje, dosja e policisë ishte dërguar në prokurori. Edhe në këtë rast, prokurori asnjëherë nuk ka iniciuar hetimet pasi që rasti nuk gjendej në regjistrin e tij të ndjekjeve. Urdhri për mbrojtje nuk e

zëvendëson ndjekjen penale e cila vazhdon të mbetet detyrim i prokurorit. Prandaj dështimi për të bërë ndjekjen penale të veprave të caktuara (duke përfshirë lëndimin e lehtë trupor), të kryera në kontekst të marrëdhënieve familjare, përbën shkelje të së drejtës vendore dhe standardeve ligjore ndërkombëtare. Në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Rregullorja përcakton një procedurë civile përmes së cilës viktimat e dhunës në familje mund të kërkojnë nga gjykata që të lëshojë urdhër për mbrojtje.

Megjithatë, kjo Rregullore nuk është e qartë në disa fusha të caktuara dhe nganjëherë gjyqtarët nuk i respektojnë dispozitat e kësaj Rregullore. OSBE-ja ka vërejtur disa vonesa të paligjshme në procedurën e vendosjes për urdhrat e mbrojtjes ose në procedurën e caktimit të seancave. Ka pasur edhe të meta të tjera ku viktimat e supozuara apo dëshmitarët kanë qenë fëmijët dhe është vërejtur mungesa e rregullave të qarta në Rregullore sa i përket asaj se a duhet që seancat të jenë publike apo jo. Të metat tjera që janë vërejtur kanë të bëjnë me përbërjen joadekuate të trupit gjykues, arsyetim të pamjaftueshëm të vendimeve gjyqësore, dhe probleme me procedurat e ankimit.⁵¹

⁵¹ Përfundimisht, OSBE-ja është shumë e brengosur për dështimin e prokurorëve në ndjekjen veprave të caktuara penale të cilat ndodhin në kontekst të marrëdhënieve familjare. Këto mangësi paraqesin shumë probleme posaçërisht kur rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e palës së mbrojtur.

KAPITULLI I KATËRT

PARANDALIMI I DHUNËS NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

1. Institucionet shkollore dhe pozita e shtrimit të dhunës ndaj nxënësve

Institucionet shkollore dhe pozita e shtrimit të dhunës ndaj nxënësve përbënë një nga themelësitë e studimit të kësaj teme shkencore, duke analizuar në themelsi dhunën në shkolla në si një dukuri shoqërore mjaft shqetësuese në aspektin shumëdimensional. Në vitet e fundit, një perceptim i përbashkët është shfaqur ku mendohet se dhuna është bërë më e përhapur nëpër shoqëri, duke e përfshirë edhe sistemin e edukimit si një nga shtyllat bazë të edukimit të fëmijëve dhe nxënësve nëpër institucionet e arsimit dhe edukimit të brezave të rinjë. Dhuna në shkolla reflekton çka është duke ndodhur në një shoqëri s'i tërësi dhe si objekt studimi i këtij punimi shkencor.

E para ka të bëjë me shkaktarët më të shpeshtë të dhunës në institucionet edukative dhe arsimore që mund të jenë:

- Programet shkollore dhe kurrikuli i shkollës nuk përshtatet dhe akomodohet me mundësitë e nxënësit dhe nuk ofron për plotësimin e aspiratave të tyre.

E dyta nëse merret për bazë themelsia dhe roli i komunitetit mund të jetë i dhunshëm ndaj nxënësve që ne kemi konstatuar nga delaratat e nxënësve dhe prindërve si konkludim në vijim.

- Janë të njohura sulmet e ndryshme që u janë bërë institucioneve të ndryshme edukative dhe arsimor nga qytetarët të ndryshëm kryesisht me probleme psikike, por edhe për arsye të ndryshme të hakmarrjes që burojnë nga treguesit psikik dhe rrëshqasin në drejtim të gabuar.⁵²

⁵² Në krahasim me numrin aktual të incidenteve, dhuna në familje në Kosovë mbetet pak e raportuar. Faktorë të ndryshëm vazhdojnë të çojnë në reagime joadekuate ndaj rasteve të dhunës në familje. Lëshimi i urdhrave të mbrojtjes për viktimat që kërkojnë mbrojtje është përmirësuar në vitet e fundit; megjithatë, policia dështojnë të bëjnë vlerësime të rregullta dhe të vlefshme për rrezikun gjatë edhe pas lëshimit të urdhrave të mbrojtjes. Mungesa e vlerësimit të rrezikut për abuzimet sistematike në rastet e dhunës në familje ka çuar në pasoja tragjike si në rastin e vrasjes së Valbona Marku-Nrecajt dhe vajzës së saj 9-vjeçare në gusht të vitit 2018.

E treta, në këtë moshë, mbi bazën e vlerësimeve të prindërve dhe arsimtarëve gjithnjë e më shumë treguesit emocional devijojnë në drejtime devijuese. Përgjithësisht, fëmijët dhe sidomos adoleshentët dështojnë në këto aspekte:

- bëhen të tërhequr nga problemet sociale dhe nuk janë të preokupuar shumicën e kohës për problemet tjera,
- rriten dozat e ankthit dhe depresionit,
- kanë probleme në të menduar dhe në përqëndrim dhe
- devijojnë nga obligimet shkollore, reagojnë para se të mendojnë etj.

Nga ana tjetër paraqiten shkaqet e delikuencës, kalojnë kohën me fëmijë problematikë, gënjejnë dhe mashtrojnë, shkatërrojnë gjërat e të tjerëve, bëhen më të padëgjueshëm në shtëpi dhe shkollë dhe shfaqin një karakter tepër të vështirë. Secili nga këta shkaktarë mund të përfshijnë edhe faktorët të tjerë në aktivitetet e dhunshme dhe kështu të shtrijë rrezën e vet të veprimit duke penguar mbarvajtjen e procesit mësimor në shkollë.

Vetë fakti se shkolla është pjesë e shoqërisë, atëherë mund të pritet që nëpër shkolla të ndodhin të gjitha llojet dhe format e dhunës të cilat mund të paraqiten, atëherë shkolla duhet të punojë shumë profesionalisht në trajtimin e të gjitha akteve të dhunës me qëllim të minimizimit të hapsirave për paraqitjen e dhunës në shkollë. E rëndësishme është që të reagohet me kohën në krijimin e një qarku të mbyllur, kur trajtohet dhuna dhe të zhduken të gjitha veprimtaritë e dhunshme.

Përcjellja e dijes është vetëm një segment nga puna e arsimtarëve. Ata japin kontribut kyç për zhvillimin emotiv dhe konjektiv të fëmijëve dhe luajnë rolin kryesor në zhvillimin shoqëror dhe ndryshimeve. Dhe krahas kësaj ,për fat të keq, disa fëmijë janë viktime të dhunës në shtëpitë e tyre, arsimtari mund të ofrojë mënyra alternative për të jetuar me atë me që do të modeloj sjellje konstruktive jo të dhunshme.

Shikuar në këtë prizëm, rëndësi ka njohja e shkaqeve të zemrimit dhe trajtimi qysh herët i shfaqjes së tyre tek fëmijët dhe të rinjtë, sepse prishja e komunikimit ndërfamiljar dhe marrëdhëniet familjare në këto rrethana nëse ato prishen apo pësojnë devijimi aty lind edhe dhunimi i dëshirave personale ose i pritshmërive.

Egzistojnë shumë faktorë për dhunën nëpër shkolla. Këtu përfshihen të kuptuarit e ndryshëm për dhunën, faktori shoqëror-ekonomik, jeta e nxënësit në shtëpinë familjare dhe rrethin e jashtëm shkollor.⁵³

Për shembull, mund të egzistojnë dallime të mëdha ndërmjet kulturave dhe shoqërive për definimin e asaj se çfarë paraqet një veprim i dhunshëm. Pa dallim nga kultura apo konteksti socio-ekonomik i shkollës, dhuna ndodh si në forma fizike, poashtu edhe në forma psikike. Dhuna në shkollë paraqet një pyetje të ndërlikuar, prandaj është me rëndësi të përfshihen faktorë të ndryshëm.

Faktorët e tillë kyçin edhe nevojën për pjesmarrje të nxënësit; me pjesmarjen e prindërve; educatorëve dhe shoqërisë; lidhshmërinë e politikës; legjislacionit dhe praktikën; zhvillimin e indikatorve për dhunë; si dhe përgaditje të rrethit të angazhohet për konceptet siqë janë të drejtat universale të njerëzve si pjesë e hyrjes e bazuar tek të drejtat e njeriut.⁵⁴

Duke analizuar situatat e këtilla në këndvështrimin e çrregullimit të gjendjes emocionale mes raporteve dhe marrëdhënieve të anëtarëve të familjes dhe shkaqeve që nxisin dhunën dhe viktimizimin ndaj fëmijëve dhe me rritjen e individit ose fëmijëve në moshë vihet re edhe *periudha rënieje* apo të çrregullimit të gjendjes së përgjithshme individuale tek fëmijët ndonjë rast edhe duke mos i përfillur urdhrat e prindërve apo anëtarëve tjerë të familjes shpeshherë shkakton prishjen e komunikimit që vjen edhe si faktor nxitës për ushtrimin e dhunës nga ana e prindërve të tyre.

2. Organet e rendit dhe të drejtësisë duhen të ndërmarrin masa adekuate sipas ligjit

Organet e rendit dhe të drejtësisë duhet të ndërmarrin masa adekuate sipas ligjit për të ndaluar dhunën ndaj fëmijëve. Nëse njëmësmdhënës ka ushtruar dhunë ndaj nxënësit të tij, drejtori i shkollës dhe Drejtoria Komunale e Arsimit duhet të ndërmarrin masa dhe ta përajshtojnë nga puna mësuesin që ka ushtruar dhunë ndaj nxënësit. Në këtë drejtim edhe më

⁵³ Afërdita Dr. Deva-Zuna e bashkautorët, Partneriteti Shkollë-Familje-Komunitet, faq. 395. Prishtinë, 2009,

⁵⁴ Theodhori DR. Karaj “Psikologjia e zhvillimit të fëmijës” faq.252 .Tiranë, 2005

tepër duhet të angazhohet edhe Sindikata e Arsimit. Derikur duhet të kuptojnë prindërit dhe mësimdhënësit se ndaj fëmijëve nuk duhet të ushtrohet dhunë ? ⁵⁵

Në këtë mënyrë vënia e kryesve përpara përgjegjësisë përmes trajtimit të dhunës në familje si vepër penale; zgjerimi i gamës së shërbimeve të ofruara për viktimat e dhunës në familje dhe përmirësimi i efektivitetit të tyre në përputhje me standardet e kërkuara - por edhe në përgjigje të të gjitha formave të dhunës ndaj grave përveç dhunës që ato pësojnë në familje; sigurimi i mbrojtjes së menjëhershme dhe trajtimit afatgjatë të të gjithë antarëve në familje të dëmtuar nga dhuna e ushtruar; apo përgatitja e një gjenerate të re e mendjehapur, pa paragjykime e stereotipe gjinore, si edhe tërësisht kundër dhunës në familje janë disa nga iniciativat që kjo strategji propozon për t'u fokusuar, me vullnetin e mirë që në vitet në vijim edhe Kosova të mund të hedhë hapat e duhur për të luftuar jo vetëm dhunën në familje, por edhe të gjitha format e tjera të dhunës ndaj grave.

Po kështu, ndonëse veprimet e propozuara mbajnë në konsideratë gjithmonë nevojat e personave të dëmtuar nga dhuna në familje, në strategji nuk mungon edhe orientimi për të filluar ndërhyrjen për trajtimin e kryesve me programe të veçanta sikundër parashikohen edhe në Konventën e Stambollit.

Kjo qasje, në asnjë mënyrë nuk nënkupton anashkalimin ndaj personave që kanë pësuar dhunë në familje dhe reduktimin e masave apo burimeve të domosdoshme për trajtimin e tyre, por na kujton rëndësinë që ka të punuarit paralelisht edhe me kryesit e dhunës - të cilët, pas përfundimit të ndëshkimit, sipas legjislacionit e në përputhje me kërkesën për penalizimin për veprën e kryer, duhet të orientohen drejt programeve rehabilituese.

3. Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Në Republikën e Kosovës fatmirësiht ekzistojnë një numër i madh i shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe kanë për synim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si në aspektin teorik ashtu edhe në bazë akitviteve të tyre qoftë si persona juridik ashtu edhe të

⁵⁵ Një poet ka thënë: I zëftë loti i fëmijës ata që ushtrojnë dhunë mbi fëmijët! Tash jemi në kohën e demokracisë, andaj ka kaluar koha e dhunës ndaj fëmijëve. T'i themi "STOP" njëherë epërgjithmonë përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve në familje dhe në shkollë.

bashkuar e në një ombrellë të vetme me synim primar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si në Komunën e Ferizajit ashtu edhe në nivel shtetëror në Republikën e Kosovës.

Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga dhuna, edhe nëse jo të gjithë pajtohen për këtë. Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duhet të punojnë më shumë në drejtim të ndaljes së dhunës në shkolla, dukeshkuar nëpër shkolla dhe duke organizuar seminare dhe tribuna përmësimdhënësit që të mësojnë se dhuna ndaj fëmijëve është e ndaluar dhe nuk është dhuna metodë e edukimit.⁵⁶

Do të ishte mirë që shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të botonin fletushka në të cilat do të shkruhej për mos përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve. Këto fletushka do të shpërndaheshin nëpër familje, por edhe nëpër shkolla, që t'i lexontesecili prind dhe secili mësimdhënës. Botimi dhe shpërndarja e fletushkës së tillë nëpër familje dhe nëpër shkolla do të kishte ndikimpozitiv në sensibilizimin e prindërve dhe mësimdhënësve që dhuna ndaj fëmijëve nuk bën të përdoret.⁵⁷

Qeveritë duhet të sigurohen që të respektohen të drejtat e fëmijës. Politikanët duhet të bëjnë atë që është e drejtë dhe të marrin qëndrim mbi këtë çështje, edhe nëse shumica e të rriturve nuk pajtohen. Në pothuajse të gjitha shtetet që e kanë ndaluar ndëshkimin trupor, shumica e të rriturve nuk janë pajtuar në fillim por pasi u nxorr ligji, më shumë njerëz ndryshuan mendjen dhe filluan të mendojnë se ndëshkimi trupor ishte i gabuar. Pas pak vitesh, të rriturit do të rishikojnë të kaluarën e tyre dhe do të habiten e turpërohen që disa njerëz kanë menduar se goditja e fëmijëve ishte në rregull. Gjithashtu, rezultatet e sondazheve për opinionet e njerëzve për ndëshkimin trupor nuk janë gjithmonë të besueshme, sepse përgjigjet që japin njerëzit mund të ndryshojnë, varësisht nga ajo se sa dinë njerëzit për këtë temë, dhe se si janë formuluar pyetjet.

Zhvillimi i shoqërive moderne na drejton në një pyetje tjetër: të drejtat e lirisë mbështetnin zhvillimin e shoqërive pluraliste që inkurajojnë një shkallë të lartë të laicizmit dhe mënyrës së individualizuar të jetesës. Si mundën këto shoqëri të ruajnë një konsensus minimal për vlerat themelore të detyrueshme të gjithë qytetarët? Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e

⁵⁶ Në çdo shkollë fillore tëmesme të ulët dhe në shkolla të mesme do të ishte mirë që nëpërkorradore të vehen pllakate të shkruara me fjalët: „Ndalë dhunës ndaj fëmijëve në familje!” ‘Ndalë dhunës ndaj fëmijëve në shkolla!’ ‘Mos përdorni dhunë ndaj fëmijëve!’ ‘Mos i rrahni fëmijët se loti i tyre mallkon!’ „Tërë bota nuk vlen as sa një lot i fëmijës!” Të shkruheshin pllakate të tjera të ngjashme, në mënyrë që arsimtarëve çdoherë t’u kujtohet që mos të përdorin dhunë ndaj nxënësve, të cilët janë duke u rritur.

⁵⁷ Ahmet Pillana “Stop” dhunës ndaj fëmijëve në familje dhe në shkolla, Postuar: Prishtinë, 2016

fëmijëve kanë kontribuar jashtëzakonisht për ta bërë botën një vend më të sigurt dhe më human për të jetuar dhe për modernizimin e sistemeve politike, ekonomike dhe kulturore në të gjithë botën.⁵⁸

Megjithatë, ato kurrë nuk duhet të merren si të mirëqena dhe çdo brez duhet të kontribuojë në zhvillimin e tyre, t'i rishqyrtojë ato përsëri dhe të luftojë për to dhe për të përmbushur angazhimin për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve në të ardhmen. Të drejtat e njeriut, mbi të cilat mbështeten të drejtat e fëmijëve, kanë një traditë të gjatë, me shumë pararendës dhe paralele në fetë dhe filozofitë më të mëdha botërore.⁵⁹ Të drejtat moderne të njeriut u shpallën në epokën e Iluminizmit dhe frymëzuan revolucionet në Amerikë dhe Francë. Sot, ato janë përfshirë si deklaratat e të drejtave në kushtetutat e shkruara dhe të pashkruara të demokracive moderne.

Gjatë gjithë historisë së tyre, të drejtat e njeriut kanë qenë me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të dobët kundër të fortit. Këtu është vendi, ku të drejtat e fëmijëve, bëhen të rëndësishme: të miturit janë në mesin e grupeve, me statusin ligjor të më të dobët, kundrejt fuqive ekzekutive. Procesi njerëzor i të drejtave njerëzore, si ai revolucionar edhe ai evolucionar, kanë prodhuar breza të tërë të të drejtave të njeriut: të drejtat klasike të lirisë, të drejtat sociale të përqendruara në vlerën e barazisë dhe, ende në diskutim e sipër, atë të të drejtave ekologjike dhe shoqërore që trajtojnë çështje të zhvillimit dhe varësisë reciproke në një botë gjithnjë e më të globalizuar dhe, si specifikim i mëtejshëm, në të drejtat e fëmijëve.

Rëndësia e të drejtave të njeriut është rritur në kuadrin e etikës laike, sikundër janë kodifikuar nga Karta e OKB-së dhe Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut. Ato përfaqësojnë të vetmin grup vlerash që qëndrojnë si një rast i pranuar universalisht nga komuniteti botëror. Megjithatë, një shtet mund të keqpërdorë të drejtat e tij të sovranitetit si mbrojtje ndërsa shkel të drejtat themelore të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve e të qytetarëve të saj. Çështja e hapur se si të mund të zbatohen dhe mbrohen të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve

⁵⁸ Çdo e drejtë e shkruar në konventë është e natyrshme për dinjitetin njerëzor dhe për zhvillimin e harmonishëm të çdo fëmije. Konventa mbron të drejtat e fëmijëve me vendosjen e standardeve në kujdesin shëndetësor, arsimin dhe shërbimet ligjore, civile dhe sociale. Këto standarde janë etaloni kundrejt të cilave mund të vlerësohet progresi. Shtetet që janë palë në konventë janë të detyruar të zhvillojnë dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet dhe politikat nën dritën e interesave më të mira të fëmijës.

⁵⁹ Aleks Luarasi „Marrëdhëniet familjare” faq.123, Luarasi, Tiranë, 2001.

në një botë të shteteve sovrane, duke përfshirë demokracitë dhe diktaturat mbetet ende një çështje e hapur. Karta e OKB-së, me sa duket, duhet të zhvillohet më tej për të mbrojtur paqen, jo vetëm ndërmjet, por edhe brenda vetë shteteve.

4. Korniza ligjore nacionale dhe ndërkombëtare

Korniza ligjore duhet t'i mbrojë viktimat në situata të tilla. Këto traktate ndërkombëtare plotësohen me instrumente tjera. Ndonëse nuk janë ligjërish të detyrueshme, instrumentet përcaktojnë standardet dhe shtjellojnë parimet për luftimin e dhunës në familje. Për shembull, Deklarata për eliminimin e dhunës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1993 kërkon që shtetet anëtare të ndjekin, përmes të gjitha masave të duhura, politikën e eliminimit të dhunës ndaj gruas. Gjithashtu, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka adresuar çështjen e dhunës në familje ndaj grave përmes disa rekomandimeve dhe rezolutave. Në Kosovë, dhuna në familje nuk përbën veprë të veçantë penale. Megjithatë, Rregullorja kërkon që veprat penale të lëndimeve të lehta trupore dhe dëmet pronësore të “ndiqen penalisht sipas detyrës zyrtare” nëse ato kryhen në kontekst të marrëdhënies familjare.⁶⁰

Veç kësaj, në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), disa vepra penale mund të ndëshkohen me dënime më të larta nëse janë kryer kundër personit me të cilin kryesi i veprës ka marrëdhënie familjare. Rregullorja, e cila ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2003, parasheh një procedurë të re civile, sipas së cilës viktimat e dhunës në familje mund të parashtrojnë kërkesë për urdhër për mbrojtje, urdhër për mbrojtje emergjente, ose urdhër për mbrojtje emergjente të përkohshme. Rregullorja përmban një listë gjithëpërfshirëse të veprave apo shkeljeve të cilat mund të bien në kategorinë e dhunës në familje, nëse kryhen kundër një personi me të cilin kryerësi është apo ka qenë në marrëdhënie familjare.⁶¹

Marrëdhënia familjare është e definuar gjerësisht sipas Rregullores si marrëdhënie mes dy individëve të cilët janë të fejuar, të martuar apo bashkëjetojnë pa kurorëzim, të cilët ndajnë

⁶⁰ Zhvillimi dhe zgjerimi i të drejtave të njeriut dhe i të drejtave të fëmijëve është ende dhe ndoshta gjithmonë do të jetë në proces: pretendimi universal i të drejtave të njeriut dhe i të drejtave të fëmijëve ka qenë gjithmonë në pikëpyetje. Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve janë deklaruar nga diktaturat dhe regjimet autokratike në gjithë botën dhe zhvillimi dinamik i shoqërisë moderne dhe i teknologjisë shtron pyetje dhe sfida të reja. Për shembull, si mund të mbrohet privatësia e komunikimit në epokën e internetit?

⁶¹ Understanding child abuse and neglect, Cynthia Crosson – Tower, 1999.

një shtëpi dhe kanë lidhje gjaku, martesore ose birësimi apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat dhe mbesat, vëllezërit e motrat, hallat e tezet, axhallarët e dajallarët, ose kushërinjtë ose ata që janë prindër të fëmijës së përbashkët. Rregullorja gjithashtu përmban një listë masash që mund të përdoren në urdhër për mbrojtje, urdhër për mbrojtje emergjente dhe urdhër për mbrojtje emergjente të përkohshme. Ajo thekson se shkelja e urdhrave të tillë përbën vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare (ex officio). Përfundimisht, ekziston e drejta për ankesë kundër vendimit për urdhër për mbrojtje, ose kundër konfirmimit të urdhrit për mbrojtje emergjente. Ankesa duhet të parashtrohet në afat prej tetë ditëve nga lëshimi i vendimit, ndonëse ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit.

Gjatë këtyre 15 viteve, autoritetet e Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të krijuar një kuadër ligjor dhe të politikave, që parashikon trajtimin e dhunës ndaj grave me qëllim përmirësimin e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat. Pavarësisht nga progresi i bërë, zhvillimet janë përqendruar kryesisht te përgjigjja ndaj dhunës në familje, ndërsa format e tjera të dhunës ndaj grave janë trajtuar pak ose mungojnë fare në axhendën e politikëbërësve. Në Kosovë, nuk ekziston ndonjë ligj apo strategji gjithëpërfshirëse që të trajtojë të gjitha format e dhunës ndaj grave apo dhunën mbi baza gjinore.

Neni 4 shprehet më tej se: Dhuna në baza gjinore është një formë e diskriminimit, e cila seriozisht pengon aftësinë e femrave dhe meshkujve që t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë në baza të barabarta, dhe është e ndaluar". Sidoqoftë, duket se Neni 4 nuk i jep rëndësi faktit se dhuna mbi baza gjinore është një fenomen që prek në masë dërmuese gratë dhe vajzat dhe është si shkak, ashtu dhe pasoja e shpërndarjes së pabarabartë të pushtetit ndërmjet burrave dhe grave, që rezulton në pozitën e nënshtruar të grave në të gjitha fushat e jetës. Format e ndryshme të dhunës ndaj grave, parashikuar në Konventën e Stambollit, janë shfaqje të dhunës mbi baza gjinore, e cila është dhunë që drejtohet kundër një gruaje, sepse është grua, apo që prek gratë në shumicën dërmuese. Si e tillë, ajo nuk duhet konsideruar si abuzim që përjetohet personalisht nga gratë, por duhet kuptuar si një mekanizëm social për t'i mbajtur gratë në gjendje të nënshtruar. Kjo nuk vlen njëloj për burrat, ndonëse pranohet se edhe ata përjetojnë dhunë dhe abuzim në jetën publike ose private.

Për rrjedhojë, LBGJ nuk i jep rëndësi natyrës strukturore të dhunës mbi baza gjinore, fakt ky që është tregues për qasjen asnjëse nga pikëpamja e gjinisë që aplikon Kosova ndaj dhunës

që prek gratë, sidomos ndaj dhunës në familje. Së fundi, në LBGJ dhe as në ndonjë ligj tjetër të Kosovës dhuna ndaj grave nuk pranohet si shkelje e të drejtave të njeriut.⁶²

Dënime më të larta parashikohen për raste kur “kryesi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës 16 dhe 18 vjeç”.⁶³ Sidoqoftë, në KPC nuk përmendet në mënyrë të shprehur dhunimi bashkëshortor dhe dhuna seksuale ndaj bashkë - shorteve dhe partnereve. Sterilizimi i detyruar parashikohet si shkelje, por vetëm në kontekstin e krimeve kundër 23 Kodi Penal nuk e përdor termin ndjekje, por, në fakt, përdor termin “ngacmim”. Sidoqoftë, përkufizimi i Kodit Penal përkon me modelin e sjelljes që shpreh Neni 34 i Konventës së Stambollit. Ndër to përfshihet dhuna seksuale; prishja e integritetit seksual; abuzimi seksual ndaj personave me çrregullime mendore apo emocionale ose aftësi të kufizuara dhe i personave nën moshën 16 vjeç; dhe abuzimi seksual duke shpërdoruar pozitën, autoritetin ose profesionin.⁶⁴

Megjithëse dhuna në familje, dhuna psikologjike dhe gjymtimi i organeve gjenitale femërore nuk specifikohen në Kodin Penal në vetvete, në parim, ato mund të parashikohen në dispozita të ndryshme dhe të cilësohen si krime, mjaft që të përmbushin elementet përbërës të këtyre veprave penale. Përsa i takon dhunës në familje, në mënyrë më specifike, Kodi Penal parashikon më tej se çështja penale mund të fillohet drejtpërsëdrejti për raste të lëndimit të lehtë trupor, lëndimit të rëndë trupor, kushteve të ngjashme me skllavërinë, punës së detyruar, dhunimit dhe dhunës seksuale, kur kryhen në kontekstin e një “marrëdhënieje familjare”.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 384, moskallëzimi i abuzimit ndaj fëmijës dhe i dhunës në familje përbën vepër penale. Së fundi, veprat penale që kryhen ndaj një personi për shkak të gjinisë dhe orientimit të tij seksual cilësohen si rrethana rënduese.⁶⁵ Ngacmimi seksual parashikohet dhe ndalohet në bazë të ligjeve të Kosovës për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për

⁶² Në bazë të legjislacionit penal, aborti i detyruar (Neni 184 (2)), ndjekja (Neni 186)23, dhunimi (Neni 230) dhe martesa e detyruar (Neni 246) përbëjnë vepra penale specifike. Dënime më të larta parashikohen për ndjekjen që kryhet ndaj një ish partneri apo partneri aktual ose ish anëtarë apo anëtarë aktual të familjes (Neni 186 (2)). Kodi Penal (KP) nr. 04/L-082, gjithashtu, jep një përshkrim të një numri aktesh jokonsensuale që klasifikohen si dhunë seksuale (Neni 232)24.

⁶³ Neni 230 (4.8) dhe Neni 232

⁶⁴ Krijimi i hartës së shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë Page 6 njerëzimit (Neni 149 (1.7)).

⁶⁵ (Neni 74 (2.12)).

barazinë.⁶⁶ Sanksionet ligjore parashikohen në formën e gjobave civile, ndërsa shkeljet që përbejnë vepra penale trajtohen në përputhje me Kodin Penal.

Vitet e fundit, Republika e Kosovës ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm edhe përsa i takon sigurimit të dëmshpërblimit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit, domethënë, me miratimin e një plani veprimi për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara Nr. 1325, një nga rezultatet e të cilës përfshin sigurimin e dëmshpërblimit për të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe mbi baza gjinore gjatë konfliktit; me krijimin e Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës së Kosovës për sigurimin e një përgjigjeje të koordinuar; dhe me miratimin e ligjit nr. 04/L-17228 që, ligjërisht, njohu statusin e viktimave civile të dhunës seksuale gjatë konfliktit të armatosur.

Për rrjedhojë, këto forma të dhunës nuk trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke i konsideruar parandalimin, mbrojtjen dhe ndjekjen ligjore shtylla që garantohen nga Konventa e Stambollit.⁶⁶

5. Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj grave

Në interpretimin e KEDNG-së, Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj grave konstatoi se dhuna ndaj grave përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe se “shtetet gjithashtu mund të mbahen përgjegjëse për aktet private nëse dështojnë të veprojnë me kujdes të duhur në parandalimin e shkeljeve të të drejtave apo në hetimin dhe ndëshkimin e akteve të dhunës, si dhe në sigurimin e kompensimit.” KDF-ja thekson se ndalohet çfarëdo lloj dhune ndaj fëmijëve dhe kërkon nga shtetet që të nxjerrin “tërë legjislacionin e duhur për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, lëndimeve apo abuzimeve, lënies pas dore apo trajtimit mospërfillës, keqtrajtimit apo shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual, gjatë kujdesit të prindërit,

⁶⁶ Të hulumtosh referuar rasteve aktuale në misterin që karakterizon faktorët nxitës është një mision i cili kërkon një vlerësim analitik. Shoqëria shqiptare ka pësuar një zhvillim galopant, kjo ndikuar edhe nga masat emigratore dhe ato imigratore të cilat në çdo rast tentojnë të sjellin një frymë të civilizuar së të jetuarit. Përballja e menjëhershme me një stil jetese të ndryshëm në zonat urbane apo tentativa për të përçarë në metropolin shqiptar një frymë evropiane ka ndikuar në reflektimin e të ashtuquajturës, *kryengritje të barazisë gjinore*, një sinonim terminologjik që preferoj ta përdor për të reflektuar dëshirën dhe synimin e femrës për të qenë e pavarur, e lirë dhe e barabartë. Vlerat akoma patriarkale që mentaliteti ynë vazhdon të ushqejë ndër breza e bëjnë të pamundur arritjen e këtij synimi, prandaj femra mbetet në një rol diskriminues gjinor.

kujdestarit ligjor apo personave tjerë të cilët kujdesen për fëmijën.⁶⁷ Ndalesa në nenin 3 të KEDNj-së e cila thotë se askush nuk do t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit dhe ndëshkimit poshtërues në kombinim me nenin 1, e cila i detyron shtetet që të sigurojnë që të gjithë personat brenda juridiksionit të tyre të gëzojnë të drejtat dhe liritë e përkufizuara në KEDNj, iu imponon shteteve detyrim afirmativ për parandalimin e torturës apo sjelljes poshtëruese e cila ndodh në kontekstin familjar. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 3 kërkon nga autoritetet publike që të ndërmarrin masa adekuate për të siguruar që individët të mos i nënshtrohen trajtimit çnjerëzor apo poshtërues (përfshirë dhunën në familje) nga personat fizik.⁶⁸ *Shikuar në këtë prizëm, mund të konkludojmë* se shoqëria shqiptare në Republikën e Kosovës edhe pse e dalur nga lufta e cila la pas vete pasoja të rënda si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë psikjik e material, që mund të merren s'i rrethana rrënduese që po prishin marrëdhëniet branda antarëve të familjes.

Prandaj BE-ja rekomandon që institucionet në Kosovë duhet të përcaktojnë në mënyrë të përshtatshme ngacmimin seksual dhe dhunën në familje në përputhje me Kodin Penal. Vullneti institucional për të zbatuar strategjitë relevante të dhunës në familje dhe ligjet përkatëse mbetet e një rëndësie shumë të madhe. Prandaj, reagimi shtetëror për të ofruar qasje dhe drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore mbeten të një rëndësie shumë të madhe për të ardhmen e Kosovës dhe procesin e saj të integritetit në Bashkim Europian⁶⁹

Sistemi i drejtësisë i Kosovës vazhdon të përballet me sfida sistematike, duke bërë që viktimat e dhunës në baza gjinore të jenë më të ndjeshme ndaj ofrimit të drejtësisë joefektive. Shumë prej këtyre sfidave rezultojnë nga fakti se Kosova është ende në fazat e fillimit të zhvillimit të një sistemi gjyqësor funksional. Tanimë për më shumë se një dekadë, gjykatat e Kosovës janë ballafaquar me një grumbull të lëndëve të pazgjidhura gjë që e ka vonuar drejtësinë për viktimat.⁷⁰

⁶⁷ Në mënyrë më specifike, në Rekomandimin 1582 (2002), Asambleja nxiti shtetet anëtare që të pranojnë se kanë për obligim parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e të gjitha akteve të dhunës në familje dhe të mbrojnë viktimat e dhunës në familje.

⁶⁸ Po ashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) kërkon nga shtetet që t'i ndërmarrin masat e nevojshme për të luftuar dhunën në familje.

⁶⁹ Programi Kombëtar i Kosovës për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (2017-2021) me BE, faqe 246.

⁷⁰ Deri në vitin 2017, 17 vjet pas përfundimit të luftës, janë krijuar një Komision dhe Programi i Pensionit për ata viktima dhe të mbijetuarit.

PJESA E II

STUDIMI HULUMTUES EMPIRIK DHE PIKËPAMJET
PËRFUNDIMTARE ANKETUESE

PIKËPMAJET HULUMTUESE DHE REZULTATET ANKETUESE

1. Gjendja reale dhe të dhënat hulumtuese


Në bazë të hulumtimit dhe të dhënave reale nga terreni dhe mendimi i qytetarëve të shprehur në këtë temë të masterit titulluar: „*Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020*„, U nanalizua dhuna në familje me vështirime të posaçëm keqtrajtimin e fëmijëve në rrethinën e Ferizajit.

Dhuna në familje me theks të veçantë dhuna ndaj fëmijëve dhe të rinjve është dhe mbetet një nga fenomenet më të përhapura dhe një nga krimet më të paraportuara në shoqërinë shqiptare s'i në Republikën e Kosovës ashtu edhe në hapsirat shqipfolëse dhe kjo e bënë të pamundur matjen me saktësi të përmasave të një fenomeni të tillë.

Dhuna në familje është trajtuar më shumë s'i një problem individual i cili i përket vetëm anëtarëve të familjes dhe jo shoqërisë. Sa më shumë që mësojmë mbi pasojat që le dhuna tek fëmijët, aq më të qartë bëhen masat që duhen adresuar. Si për periudhën afatshkurtër dhe atë afatgjatë, ekspozimi ndaj dhunës gjatë fëmijërisë ka pasoja jashtëzakonisht negative s'i për shëndetin mendor dhe atë fizik e emocional.

Me rritjen e individit në moshë vihet re edhe periudha rënies apo të çrregullimit të gjendjes së përgjithshme emocionale që është një tregues ekzakt i rënies së nivelit të shkathtësisë emocionale ndodh midis moshës shtatë dhe katërmëdhjet vjeç. Në këtë moshë, mbi bazën e vlerësimeve të prindërve dhe arsimtarëve gjithnjë e më shumë treguesit emocionale rrëshqasin në drejtim të gabuar dhe shpeher nga ana e prindërve të tyre nuk kuptohen dhe prishin raportet prind fëmijë dhe në të shumtën e rasteve, këtu fillon edhe faza e parë e paraqitjes së dhunës nga ana e prindërve ku ka raste këto shqetësime kalojnë edhe në dhunë fizike Brenda raporteve dhe marrëdhënieve familjare.

Studimi hulumtues dhe shkencorë do të ndihmojë në trajtesën e sajë shumëdimensionale, sa i përket shumëllojshmërisë së dhunës si veprim penalo-juridik e gjyqësor, ku objekti i krahasimit ndryshon sipas shkallës së studimit, paralelisht me zgjedhjen problemeve të ndryshme që ballafaqohen viktimat në Regjionin e Ferizajit në Republikën e Kosovës.



Norma e rasteve të hedhura poshtë të dhunës në familje mbetet e lartë, pasi gjatë vitit 2017 ishin më shumë se gjysma e të gjitha kallëzimeve penale të lidhura me rastet e dhunës në familje (51.5%) që ishin hedhur poshtë nga gjykatat e Kosovës. Për më tepër, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, u hodhën poshtë gjithsej 15.1% raste. Për periudhën e monitoruar për 2015-2018, vetëm 40.4% e rasteve kanë marrë vendime të fajësisë. Kjo përgjigje e ngadaltë nga sistemi i drejtësisë penale ndaj rasteve të dhunës në familje ka çuar në shfaqjen e përgjithshme të mosndëshkimit për autorët e dhunës në familje. Për më tepër, viktimat që fajësohet dhe pajtimi i viktimës me kryerësin mbetet e zakonshme në mesin e të gjitha institucioneve të monitoruara, shpesh të justifikuara me qëllim të *shpëtimit* të familjes tradicionale.

2. Parë në këndvështrimin hulumtues dhe atë empirik

Parë në këndvështrimin hulumtues dhe atë empirik si dhe pyetësorit që kemi parashtruar më një numër të qytetarëve të Republikës së Kosovës do të japë disa përgjigje nga hipotezat e parashtruara në këtë punim shkencor të masterit titulluar: *„Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020,,* Hulumtimet

empirike në kuadër të këtij punimi të masterit përbëhet nga realizimi i pyetësorit anketues të 100 personave të pyetur, të cilët dhanë mendimin e tyre për këto pyetje dhe me kënaqësi i'u përgjigjen pyetjeve tona të parahstruara në këtë pyetësor hulumtues.

3. Përfshirja e grupmoshave të ndryshme

Gjithashtu në këtë pyetësor janë përfshirë edhe grupmoshat e ndryshme ku 16 0% deri më 34 0% janë përfshirë grupmoshat e reja e ato studentore duke filluar nga ato universitare në Komunën e Ferizajit me rrethinën, si dhe me juristë ekspertë palë ndërgjyqëse etj. Me realizimin e pyetësorit anketues dhe analizimi i rezultateve të fituara nga ky anketim, na mundësoi që të kemi një pasqyrë më reale për pozitën e të drejtës gjyqësore në Republikën e Kosovës në përgjithësi si dhe konkludimet shkencore që preferojnë disa ndryshime elementare për sfidat e të drejtave të njeriut dhe të drejtat gjyqësore në Republikën e Kosovës kur bëhet fjalët për të drejtat e palëve në një proces juridiko-penal.

Analizimi i të gjitha të dhënave të mbledhura nga terreni në lidhje me anketimin dhe përfitimi i të dhënave relevante për njohjen e gjendjes reale të të drejtave të palëve dhe viltimave në një proces gjyqësor juridiko-penal apo të drejtat e njeriut, përcjellin se cilat drejtime shkencore duhet ndjekur, cilat veprime duhet të ndërmerren Shteti i Republikës së Kosovës.

Parë në këtë prizëm, rezultatet e fituara nga anketimi i 100 qytetarëve të grupmoshave dhe të sferave të ndryshme të shoqërisë, nga të cilët më shumë janë përfshirë qytetarë të grupmoshave të ndryshme si; fëmijë, student, jurist, punojnës policie, avokat pedagog etj, të punësuarit në sektorin joqeveritarë, punonjës të të drejtave të njeriut nëpër institucione të ndryshme të cilët pikërisht merren me këtë materie, si dhe ekspertë e studiues të kësaj lëmie, nga e cila do të kompletohet i gjithë punimi shkencor i masterit, dhe do të ndikojë që të rezultojë me të dhëna konkrete, konkludime shkencore, si dhe udhëzimet dhe veprimet që duhen ndërmerren për të mbrojtur mirëqenien e njeriut se faktori kryesorë i të drejtave juridiko-penale.

4. Të dhënat e përpunuara anketuese

Të dhënat anketuese, dëshmojnë për një situatë shqetësuese në disa drejtime si ato; të gjyqimit të stërgjatur, si në kënvështrimin penal ashtu edhe në atë civil, të drejtat sociale, të

drejtat dhe ekonomike, të drejtat politike pozitive e cila reflektohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, si; për nga vështirësitë ekonomike, sociale, zbardhja e rasteve të dhunës në familje dhe shoqëri etj. Mbështetur në rezultatet e hulumtimit dhe sjelljen e rezultateve përfundimtare të punimit të masterit titulluar; „*Dhuna në familje me vështirësi të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020*„, është shfrytëzuar një literaturë e konsiderueshme, si nga vendi ashtu edhe nga jashtë, duke theksuar edhe literaturën e shtetit dhe trojeve të tjera shqiptare, me një qëllim të vetëm që të arrihet qëllimi kryesor i këtij punimi dhe të detektohen problemet elementare që po përballen shoqëria e shqiptare në Republikën Kosovës me theks të veçantë Regjionin e Ferizajit. Nga kjo që thamë më lartë rezulton se nga realizimi i hulumtimit të përgjithshëm empirik dhe shkencor do të nxirren edhe konkludimet dhe propozimet për një mbrojtje më efektive ndaj abuzimeve, shkeljeve, përkufizimeve të të drejtave të fëmijëve dhe grave në një proces juridiko-penal në Republikën e Kosovës me theks të veçantë në atë gjyqësor dhe të praktikës gjyësore të Regjionit të Ferizajit.

5. Roli i punimit empirik gjatë studimit

Hulumtimi empirik i punimit shkencor të masterit përbëhet nga pyetësi anketues, ndaj 100 qytetarëve të sferave të ndryshme, që përmban 10 pyetje të cilat përfshijnë; kufizimet e të drejtave gjyqësore, abuzimi, e drejta e sigurisë, e drejta politike, si dhe të drejtat tjera ndihmëse që kanë të bëjnë me objektin e studimit të këtij punimi shkencor. Qëllimi i këtij studimi empirik ka qenë që të arrihet deri tek rezultat e mirë pritura, të përpunuara dhe studiuar nga të dhënat relevante të qytetarëve ekspertëve dhe mendimet e grupmoshave të ndryshme në lidhje me funksionimin e të drejtave të njeriut siç është e drejta e gjyqësore dhe të drejtat penale dhe ato të mbrojtjes dhe kompensimit të demëve të shkaktuara fizike e psikike të viktimave në një proces penal kur bëhet fjalë për praktikën gjyqësore.

Pyetësi është realizuar me qëllim që këto të dhëna do të na ndihmojnë në studimin e më tutjeshëm të këtij studimi kur bëhet fjalë për të drejtat juridiko-penale të palëve në një proces gjyqësor. Të dhënat e fituara nga terreni anketues janë të përpunuara nëpërmjet një analize, të fituar nga përgjigjet e qytetarëve, si dhe analizave të tyre në mënyrë shkencore, përpunimi përgjigjeve dhe paraqitje e këtyre të dhënave në mënyrë tabelore që do të na ndihmojë që studimi

të jetë sa më precizë dhe i saktë në atë që njihet si studim empirikë i punimit të mastrit titulluar; ***„Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020,,***

6. Analiza e rezultateve të fituara nga pyetësi anketues

Nga kënvështimi i studimit të dhënave të studjuara për temën e masterit titulluar : ***„Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020,,*** si dhe nga kapitujt e lartpërmendur, veçuam se pyetësi anketues është përshtatur për një grup qytetarësh prej 100 qytetarëve, nga të cilët 52 % anketuar ose bashkëbisedues për këtë temë të pyetur janë persona të cilët e njohin mirë pozitën dhe historikun e të drejtave gjyqësore apo ato juridiko-penale për dhunën në familje , dhunën ndaj fëmijëve dhe të rinjëve në Regjionin e Ferizajit dhe në Republikën e Kosovës.

7. Qasja e arsyeshmëri metodologjike

Format e ndryshme të dhunës në familje me bazë gjinore mbeten të përhapura dhe adresohen në mënyrë joefektive nga policia, prokurorët dhe gjykatat. Përgjigja institucionale mbetet larg standardeve të përcaktuara tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Sistemi përgjithësisht i dobët gjyqësor, mbingarkimi me raste, korrupsioni dhe besimi i ulët i qytetarëve ndaj institucioneve gjyqësore vazhdojnë të përkeqësojnë qasjen e dobët në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Mosndëshkimi për autorët e dhunës ndaj grave, e ndjekur nga qasja sistematike e institucioneve të përfshira për të pajtuar viktimat me autorët, janë reflektuese e mungesës së kuptimit të ndjeshëm gjinor të natyrës së dhunës kundër grave në Kosovë. Viktimat dhe të mbijetuarit e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore vazhdojnë të përballen me sfida në mbrojtjen dhe ndjekjen nga krimet e dhunës me bazë gjinore.

Kjo tregon nevojën për legjislacion dhe politika të mëtjshme efektive në përputhje me kërkesat e fundit të përshkruara a si një reagim më të përgjegjshëm ndaj prokurorisë dhe gjyqësorit, ku bëjnë pjesë edhe ekspert të cilët merren me studimin e zë drejtave të njeriut në

Republikën e Kosovës kryekëput me të drejtat e palëve si gjyqëtar, profesor, viktima të këtyre shkeljeve, qytetarë të ndryshëm dhe palë që takuam pran organeve gjyqësore në Ferizaj, dhe qytetet tjera të Republikës së Kosovës në gjykatat Themelore dhe ato të Apelit. Një premisë bazë për fillimin e një procedure penale, për ari se nëse nuk ka një interes të caktuar juridik nga pala, ajo nuk është e interesuar të inicioj procedure penale për mbrojtjen apo sigurimin e të drejtës subjektive të sajë nga edhe lindin abizimet, pasojat, shkaktimi i demit të viktimës nëse krimi nuk denohet nga palët e dëmtuara.


Mungesa e fuqizimit të kapaciteteve të profesionistëve, duhet të sigurohet që të gjithë zyrtarët përgjegjës, përfshirë zyrtarët komunal në Komunën e Ferizajit dhe zyrtarët për barazi gjinore, të marrin trajnim të mjaftueshëm për traumën, identifikimin e shenjave të dhunës në familje, qasjen e duhur për ndihmesën për viktimat e dhunës në familje, si dhe konfidencialitetin. Të inkorporohen në trajnimin e detyrueshëm të gjithë zyrtarët e policisë për informata të mëtejshme për dhunën në familje, për mënyrën e identifikimit të shenjave të traumës dhe për komunikimin me personat që kanë përjetuar trauma si rezultat i dhunës në familje. Trajnimi do të duhet të adresojë edhe keqkuptimet lidhur me paragjykimin dhe fajësimin e viktimave s'i dhe pajtimin familjar.

Shikuar në këtë prizëm, rëndësi ka njohja e shkaqeve të zemrimit dhe trajtimi qysh herët i shfaqjes së tyre tek fëmijët dhe të rinjtë, sepse prishja e komunikimit ndërfamiljar dhe marrëdhëniet familjare në këto rrethana nëse ato prishen apo pësojnë devijimi aty lind edhe dhunimi i dëshirave personale ose i pritshmërive dhe vështirë ndodh pajtimi familjar në raport me marrëdhëniet familjare dhe ato shoqërore.

ANKETA PROCEDURALE E STUDIMIT NË TERREN

PYETJA NR. 1

1. Sa keni njohuri për dhunën në familje në Republikën e Kosovës ?



Grafikon Nr.3

Sa keni njohuri për dhunën në familje në Republikën e Kosovës ?

Në këtë pyetje të anketuarit kishin mendime të ndryshme dhe u përgjigjën në këtë mënyrë: në kategorinë e grupit të parë një pjesë e qytetarëve u përgjigjën pozitivisht dhe atë me 38.1%, ndërsa në grupin e dytë të të anketuarve kishin mendime të ndryshme negative dhe një pjesë e tyre nuk u dencuan shkaku i pakënaqësive shumë të mëdha ekonomike me qëndrim negativ me rreth 50.8%. Këto ishin vetëm disa nga bindjet e qytetarëve për dhunën në familje, një grup thanë se ka shumë raste të tilla por *Shteti nuk bënë asgjë*. Shikuar në këtë prizëm, mund të konkludojmë se besueshmëria e dobët ndaj institucioneve është problem themelor e cila ul denoncimet dhe e gjithë kjo situatë shkon në favor të dhunuesve.

PYETJA NR.2

2. Sa respektohen të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës ?

- Po, respektohen
- Pjesërisht respektohen
- Aspak nuk respektohen

Pyetjet e parashtruara	Numri i përgjigjeve	Numri i përgjigjeve përshtatur në (%) përqindje
<u>1. Po, respektohen</u>	39	39 %
<u>2. Pjesërisht respektohet</u>	41	41 %
<u>3. Aspak nuk respektohet</u>	19	19 %

Grafikoni nr. 2

Në pyetjen e dytë; *Sa respektohen të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës ? Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 39 ose 39% kanë mendimin se të drejtat e fëmijëve po respektohen dhe se në vazhdimësi ka nevojë akoma më shumë për tu bërë që të arrijë qëllimi i duhur në atë që e garanton Kushtuta e Republikës së Kosovës për fëmijët dhe të rinjtë.*

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 41 ose 41 % kanë mendimin se të drejtat e fëmijëve, pjesërisht po respektohen dhe se në vazhdimësi ka nevojë ako më shumë për t'u bërë që të arrijë vendin e duhur në atë që e parshohin rregullat ligjore dhe legjislacioni i Republikës së Kosovës.

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 19 ose 19 % kanë mendimin se të drejtat e fëmijëve dhe të rinjëve, aspak nuk respektohen, prindët e detyrojnë fëmijët të dalin në rrugë, i detyrojnë në punë, varfëria familjare, „ndihma e shtetit për këtë kategori nuk bënë apo nuk ndërmer asgjë”.

Kur u pyetën në ç'mënyrë e pengon punën e tyre ky legjislacion, u përmendën këto pengesa: mungesa e specializimit të shërbimeve mbështetëse; problemet e politikave shtetërore për subvencionimin dhe mungesa e linjave të veçanta të buxhetit për rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave.

Një i anketuar u shpreh se sanksionet e parashikuara për mosinformimin e policisë pas kontaktimit të një viktime të dhunës në familje, ua vështirësojnë më shumë punën. Në pyetësin e anketimit përfshihej një grup pyetjesh specifike me qëllim vlerësimin e kategorive të gjera të shërbimeve që ofrojnë institucionet dhe organizatat.


Për t'u kuptuar nga të gjithë njësot, për çdo lloj shërbimi të gjerë u përfshinë gjithashtu përkufizime të hollësishme në bazë të të drejtave themelore të njeriut.

Tek të anketuarit konstatohet një moskuptim i përgjithshëm lidhur me atë se çfarë nënkupton “mbështetje gjatë gjithë procesit ligjor”, ndërsa disa pjesëmarrës e ngatërrojnë këtë shërbim me ndihmën juridike dhe përfaqësimin ligjor, si dhe lidhur me shërbimet që iu ofrohen viktimave, në përgjithësi kur janë në pyetje fëmijët.

Të anketuarit kanë mendimin se të drejtat e fëmijëve, pjesërisht po respektohen dhe se në vazhdimësi ka nevojë akoma më shumë për t'u bërë që të arrijë vendin e duhur në atë që e parshohin rregullat ligjore dhe legjislacioni i Republikës së Kosovës.

PYETJA NR:3

3. A keni njohuri rrethë gjykimit të drejtë dhe pa vonesë në gjyqësorin e Republikës së Kosovës për gjykimet e lëndëve për dhunën në familje?



Grafikoni Nr. 4.

Në pyetjen e katërt: *A keni njohuri rrethë gjykimit të drejtë dhe pa vonesë në gjyqësorin e Republikës së Kosovës për gjykimet e lëndëve për dhunën në familje?*


Të anketuarit lidhur me mënyrën e zgjidhjen e çështjeve juridiko-penale kishin mendime të ndara duke i trajtuar çështjet gjyqësore se lëndët penale apo shërbimet e gjykatave zgjidhen drejtë dhe pa vonesë me rreth 25.5%.

Ndërsa në nëngrupin e dytë të anketuarit përgjigjeshin në mënyra të ndryshme. Rreth 69.9 % arsyeja e mosbesimit ishte se qytetarët kan filluar ta humbin besimin në gjykatat vendore për shkaqe se shumë gjatë por edhe me vite nuk vin deri tek zgjidhje e të drejtave gjyqësore.

Shikuar në këtë prizëm, të anketuarit kanë mendime të ndryshme por, një çështje është e sigurtë se proceset gjyqësore zgjatin shumë dhe pa epilog gjyqësor, në shumicën e rasteve viktimat përsëri kthehet tek dhunuesi apo abuzuesi, gjë që viktimat në këtë rast humbasin apo dekurajohen për të denoncuar rastet e dhunës brenda familjes.

PYETJA NR.4

4. A keni besim te Policia e Kosovës në rast se denonconini dhunën në familje ?



Grafikoni Nr. 4.

Në pyetjen e katërt *A keni besim te policia e Kosovës në rast se denonconini dhunën në familje ?*

Të anketuarit lidhur me denoncimin e dhunës në familje tek organet policore të Republikës së Kosovës kishin mendime pozitive dhe rreth 69.9 % i besonin Policisë së Kosovës, por familjarët apo viktimat janë ata që nuk e denoncojnë dhunën në familje, po ashtu është me rëndësi të theksohet se të gjitha informatat që lidhen me rastin duhet të mbahen konfidenciale deri në momentin e ngritjes së akuzave, moment ky në të cilin informatat bëhen publike.

Ndërsa në nëngrupin e dytë të anketuarit përgjigjeshin në mënyra të ndryshme. Rreth 25.5% arsyeja e mosbesimit ishte se qytetarët kanë filluar ta humbin besimin në Polici me kuptimin se policia nuk mund t'i zgjidhë ngatresat familjare që përfundojnë me dhunë.

Ndodh që të ndalohej dhunuesi për një kohë të shkurtër apo dhënie e deklaratës para aorganeve përkatëse policore apo hetuese dhe përsëri kthehet tek viktimat apo ambientet

familjare dhe kështu vazhdon akoma më shumë të rëndëhohet situata për dhunë sistematike ndaj viktimës po edhe në të shumtën e rasteve edhe ndaj anëtarëve të familjes siç janë fëmijët në të shumtën e rasteve si viktimat kolaterale.

Nëngrupi tjetër mendonin se Shteti i lejon që dhunuesit të jetojnë përsëri bashkë dhe kjo nuk është e sigurtë për denoncimin dhe besimin në Policinë e Kosovës. Institucionet shtetërore luajnë një rol vendimtar në procesin e sigurimit të një trajtimi të drejtë dhe të ligjshëm të rasteve të dhunës në familje. Ato janë përgjegjëse për trajtimin në mënyrë të paanshme dhe me dinjitet të të gjitha palëve duke përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe kryesit e veprës penale. Si pjesë të procedurës civile, gjykatat shqyrtojnë kërkesat për urdhër të mbrojtjes dhe urdhërat për mbrojtje emergjente duke vendosur për masat e mbrojtjes të cilat parashikohen nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Gjykatat janë të detyruara që të marrin vendime lidhur me urdhërat për mbrojtje brenda afateve ligjore të parapara në Ligj si dhe duhet t'i shqyrtojnë rastet e dhunës në familje si çështje me përparësi. Mirëpo në praktikë të anketuari kanë shumë vërrejtje sepse ajo që është drejtë palët ndërgjyqëse nuk fitojnë në bazë të procedurave ligjore.

PYETJA NR.5

5. Sa jeni të kënaqur me punën e Komunës së Ferizajit në luftimin e dhunës në familje dhe ato të fëmijëve dhe të rinjëve ?

- Pak ; Shumë pak;
- Aspak
- Nuk di

	Numri i përgjigjeve	Numri i përgjigjeve përshtatur në (%) përqindje
Pak	28	28 %
Shumë pak	11	11 %
Aspak	39	39 %

Nuk e di	22	22 %
-----------------	-----------	-------------

Grafikon nr.7

Në pyetjen e shtatë nga numri i qytetarëve të anketuar se; Sa jeni të kënaqur me punën e Komunës së Ferizajit në luftimin e dhunës në familje dhe ato të fëmijëve dhe të rinjëve ?

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 28 të anketuarve ose 28 % kanë mendimin se pak janë të kënaqur me punën e Komunës së Ferizajit.

Shikuar në këtë prizëm, mund të konkludojmë se shumë aktivitete mbahen në lidhje me sensibilizimin e qytetarëve në lidhje me këtë temë, por akoma qytetarët mendojnë se pak është bërë sa janë mundësitë dhe kapaciteti i kësaj komune, deri tani nga ana e Komunës së Ferizajit për të prevenuar apo ndaluar ose zbutur dhunën në familje ose abuzimet e tjera që ndodhin brenda në familje apo tek fëmijët pak janë të kënaqur.

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 11 të anketuarve ose 11 % kanë mendimin se shumë pak janë të kënaqur me punën e Komunës së Ferizajit me devijimet familjare. Të akntuarit mendojnë se po të ishte komuna më aktive edhe numri i abuzuesve do të ishte më i vogël.

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 39 të anketuarve ose 39 % kanë mendimin se aspak nuk janë të kënaqur me punën e Komunës së Ferizajit.

Të anketuarit edhe në këtë pyetje ndajnë mendime të ndryshme duke shprehur se zyrtarët komunal janë më të interesuar për interesat e tyre personale se sa çfar ndodhë brenda në familje, njëri nga të anketuarit u shprehë: „mund ta shifni edhe vet se sa fëmijë rrugëve të Ferizajit bredhin dhe lypin nëpër kafena, kjo është interesimi komunal për këtë kategori të fëmijëve,, prandaj jo se nuk jemi të kënaqur por jemi edhe të revoltuar me Komunën e Ferizajit.

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 22 të anketuarve ose 22 % nuk kanë njohuri dhe se nuk e dijnë a duhet të merret Komuna e Ferizajit me këto çështje familjare apo dhunën në familje.

Në këtë nënpyetje ishin përgjigju grup-moshat më të reja edhe nuk kishin edhe aq interes për t'u shprehur për çështjen në fjalë por dhanë përgjigje sipërfaqësore në përjashtim të individëve që kishin qenë pjesë e abuzimeve në familje.

Nga të anketuarit mund të konkludojmë se përkundër këtyre përmirësimeve, gati një e treta e kosovarëve besojnë se në familje dhuna është pjesë normale e çdo marrdhënieje dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna mund të ndodhë ndonjëherë.

PYETJA NR.6

6. Cilat institucione shtetërore nuk e luftojnë abuzimin dhe dhunën në familje dhe të drejtat e fëmijëve ?

- Qeveria
- Shkollat
- Policia
- Gjykatat
- Qendra për mirëqenie sociale

Pyetjet e parashtruara	Numri i përgjigjeve	Numri i përgjigjeve përshtatur në (%) përqindje
Policia	20	20 %
Shkollat	9	9 %
Qendra për mirëqenie sociale	39	39 %
Gjykatat	21	21%
Qeveria	11	11%

Grafikon Nr.8

Në pyetjen e gjashtë nga numri i qytetarëve të anketuar se; *Cilat institucione shtetërore nuk e luftojnë abuzimin dhe dhunën në familje dhe të drejtat e fëmijëve ?*

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 20 të anketuarve ose 20 % kanë mendimin se *organet policore* janë ata që i përkufizojnë të drejtat e palëve në Republikën e Kosovës. Ndërsa një grup tjetër i të anketuarve shprehet se kur është pyetje për dhunën në familje janë organet policore që kanë përgjegjësi shumë të lartë për të marrë masa ndaj abuzuesve për të prevenuar dhe penduar keqërsit në fjalë.

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë nën pyetje rreth 9 të anketuarve ose 9 % kanë mendimin se *partitë në pushtet* janë ata që i përkufizojnë të drejtat e palëve në Republikën e Kosovës nga se më shumë janë të interesuar për përfitime personale apo grupe se sa për interesat e përgjithshme që qytetarëve nuk nuk hezitojnë të folin edhe për kriminalitetin si dukuri shqetësuese për shoqërinë në Kosovë.

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë nënpyetje rreth 39 të anketuarve ose 39 % kanë mendimin se korrupsioni është faktori kryesor që i përkufizojnë të drejtat e palëve në Republikën e Kosovës. Shikuar në këtë prizëm me të drejtë të anketuarit shprehen ashtu sespe korrupsionin aktualisht shkatëron dhe rrënon gjithçka që është në interesin publik.

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 21 të anketuarve ose 21 % kanë mendimin se organet gjyqësore janë ata që i përkufizojnë të drejtat e palëve në Republikën e Kosovës. Është me rëndësi të vlerësojmë se sistemi gjyqësor është një nga problemet bazë për funksionimin e shtetit dhe së drejtës në Republikën e Kosovës nga ka edhe shumë vërrejtje edhe nga faktori ndërkombëtar.

Nga numri i qytetarëve të anketuar në këtë pyetje rreth 11 të anketuarve ose 11 % kanë mendimin se qeveria dhe organet qeveritare janë ata që i kufizojnë të drejtat e qytetarëve si në Regjionin e Ferizajit ashtu edhe në tërë Republikën e Kosovës. Nga kjo mund të konkludojmë dhe shprehemi se në këto përgjigje një numër i qytetarëve ndanin mendimin se rrëzimi i qeverive shumë shpesh apo zgjedhjeve të parakohshme që ndodhin në Republikën e Kosovës janë shkaktaër apo indiciet që shumë të drejta të qytetarëve të kufizohen nga mosfunksionimi i institucioneve qendrore.

Nga anketimi dhe pyetësi apo përgjigjet e të anketuarve konstatojmë se: informimi, vetëdijësimi, edukimi dhe arsimimi janë shumë indikator të rëndësishëm që duhen vëmendje të veçantë për prevencion e dhunë në familje.

Të vlerësohet nga studjuesit shkencor çështja e mentalitetit të vjetër që u konstatua nga të anketuarit se përkundër këtyre përmirësimeve, „gati një e treta e kosovarëve besojnë se në familje dhuna është pjesë normale e çdo marrdhënie dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna mund të ndodhë ndonjëherë, Të përdoren fushatat sensibilizuese për edukimin e qytetarëve për të drejtat dhe obligimet e tyre, si dhe se ku mund ta raportojnë dhunën duke përfshirë edhe raportimin në institucione të ndryshme.

Të krijohet një plan publik gjithëpërfshirës më i konsoliduar, ku të përfshihen akterë të ndryshëm me mesazhe të përbashkëta dhe të drejtuara kah grupet e synuara.

Të sigurohet një qasje më e koordinuar mes akterëve të ndryshëm për rritjen e sensibilizimit, në drejtim të shpenzimit më efikas dhe efektiv të burimeve.

Të organizohet një fushatë për promovimin e shërbimeve të këshillimit psikologjik dhe për arsyet se pse këto janë të mira për gjithë shoqërinë, në drejtim të adresimit të pengesave kulturore me të cilat përballen njerëzit që kërkojnë këshillim psikologjik.

Të merren të gjitha masat për përmirësimin e perceptimit të shoqërisë ndaj fenomenit të dhunës në familje dhe trajtimit të tij me *zero tolerancë*, duke nxitur mbështetjen e viktimave dhe vënien e kryesve përpara përgjegjësisë.

Të përfshihen në planprogramet mësimore informata të përditësuara lidhur me rolet gjinore, socializimin, parandalimin e stereotipeve gjinorë dhe dhunën në familje.

PËRFUNDIMI

Tema shkencore e masterit titulluar: „*Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020*„. Kishte për objekt studimi dhunën në familje me vështirime të posaçëm keqtrajtimin e fëmijëve në rrethinën e Ferizajit. Dhuna në familje posaçërisht ndaj fëmijëve dhe të rinjëve është dhe mbetet një nga fenomenet më të përhapura dhe një nga krimet më të paraportuara në shoqërinë shqiptare s'i në Republikën e Kosovës ashtu edhe më gjërë në shoqërinë bashkëkohore.

Dhuna në familje është trajtuar më shumë si një problem individual i cili i përket vetëm anëtarëve të familjes dhe jo shoqërisë faktor që akoma më shumë inkurajon dhunuesit dhe rrit numrin e viktimave në familje. Sa më shumë që mësojmë mbi pasojat që le dhuna tek fëmijët, aq më të qartë bëhen masat që duhen adresuar për këtë problematikë devijuese në shoqëinë shqiptare gjegjësisht në rrethin e Ferizajit dhe në tërë Republikën e Kosovës. Si për periudhën afatshkurtër dhe atë afatgjatë, ekspozimi ndaj dhunës gjatë fëmijërisë ka pasoja jashtëzakonisht negative s'i për shëndetin mendor ashtu edhe për atë emocional e fizik. Shikuar në këtë prizëm, punimin shkencor të temës së masterit në bazë të gjitha parametrave shkencor dhe hulumtues s'i dhe faktorëve për shkaqet e dhunës tek fëmijët dhe të rinjtë konkluduar se:

📌 Me rritjen e individit në moshë vihet re edhe periudha rënije apo të çrregullimit të gjendjes së përgjithshme emocionale që është një tregues ekzakt i rënies së nivelit të shkathtësisë emocionale ndodh midis moshës shtatë dhe katërmëdhjet vjeç. Në këtë moshë, mbi bazën e vlerësimeve të prindërve dhe arsimtarëve gjithnjë e më shumë treguesit emocionale rrëshqasin në drejtim të gabuar dhe shpeher nga ana e prindërve të tyre nuk kuptohen dhe këto rrethana komunikuese prishin raportet prind-fëmijë dhe në të shumtën e rasteve, këtu fillon edhe faza e parë e paraqitjes së dhunës nga ana e prindërve dhe këto raste kalojnë edhe në dhunë emocionale, psikike dhe fizike.

Studimet dëshmojnë se jo rrallë her si baballarët ashtu edhe nënat janë pothuaj njëlloj të dhunshëm ndaj fëmijëve të tyre. Nënëat ushtrojnë më shumë dhunë ndaj vajzave të tyre, duke e justifikuar këtë me mendesitë se dhuna është e domosdoshme si mjet detyrimi që vajzat të mos marrin rrugë të keqe apo devijuese, se dhuna ka shpëtuar shumë vajza adoleshente nga degjenerimi e kausi shoqëror që përjeton Republika e Kosovës në këtë rast edhe Komuna e

Ferizajit, se dhuna ndaj fëmijëve apo vajzave është pjesë e përgjithësisë dhe e kontrollit të nënave ndaj tyre, se vajzat më mirë të zemerohen me nënat, që i detyrojnë dhe me dhunë të shkojnë në rrugë të mbarë, se sa t'i mallkojnë gjithë jetën për shkarjet nga lëshimet liberale të tyre.

Nga ana tjetër e studimit shkencor të temës në fjalë konkludua se dhuna në shtëpi pamundëson sigurinë dhe qetësinë, prek fëmijët, gratë, personat e moshuar dhe anëtarët e tjerë të familjes. Dhuna në familje haset në forma të ndryshme, shpeshherë pasojat janë të dukshme, mirëpo ndonjëherë ajo është e mbuluar dhe e fshehur. Ndodh që të bëhet fjalë për dhunë fizike, dhunë seksuale, dhunë psikologjike dhe ekonomike. Çfarëdo që të jetë forma e dhunës, nga ajo më së shumti vuajnë, fëmijët, grat, pleqtë dhe personat me aftësi të kufizuara *me nevoja të veçanta*. Në të shumtën e rasteve grate janë viktimë e dhunës direkte ndërsa fëmijët viktimë të dhunës direkte dhe indirekte. Çdo e dyta grua është viktim e dhunës psikike, çdo e pesta grua është viktim e dhunës fizike dhe çdo e dhjeta grua është viktim e dhunës seksuale. Pasojat nga ushtrimi i dhunës në familje janë fatale për shoqërinë, ato lëjnë gjurmë s'i tek personi e familja poashtu edhe në tërë shoqërinë, pasi ndikojnë në zhivillimin psikikofizik sidomos të fëmijëve, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në personalitetin e tyre, pasojat janë tepër të dukshme edhe në shëndetin e viktimave të dhunës, pasoja të cilat duhen një kohë të gjatë të kurohen në Qendra rehabilituese nga ku pak për së paku do të minimizoheshin këto pasoja ose do të lehtësoeshin.

Shikuar në këtë prizëm temën e studimit të masterit titulluar: „*Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020*„, do të kontribojë sa do pak si punim shkencor për dhunën në familje me vështirim të posaçëm keqtrajtimin e fëmijëve në rrethinën e Ferizajit. Mjaft fakte juridiko-penale provojnë se në familje epokën e fundit, fëmijët u nënshtrohen formave të ndryshme të dhunës së prindërve të tyre së paku deri në fund të moshës së adoleshencës. Rregullimi i dhunës në familje në legjislacionin pozitiv e numëron Republikën e Kosovës në rendin e atyre shteteve të cilat përpos ofrimit të ndihmës së obliguar adekuate të viktimës së dhunës në familje, aplikoi edhe mbrojtje juridike komplementare të viktimave të këtyre rasteve.

Rekomandime - Për gjyqtarët, prokurorët dhe policinë: Kur të vendosin për kërkesat për urdhër për mbrojtje, gjyqtarët duhet të veprojnë në përputhshmëri me ligjin përkatës dhe të

vendosin për kërkesat brenda afateve të përcaktuara kohore. Gjyqtarët duhet të arsyetojnë në mënyrë adekuate vendimet e tyre në rastet e dhunës në familje, përmes vendimeve të qarta dhe të arsyetuara mirë me referencë në fakte të rastit. Gjyqtarët duhet të sigurojnë prezencën e përfaqësuesit të QPS-së në procedurat që kanë të bëjnë me dhunën në familje kur njëra nga palët e mbrojtura është i mitur. Prokurorët duhet të hetojnë rastet shpejtë dhe nëse është e nevojshme të ndjekin me kujdes të duhur personat të cilët mund të kenë kryer vepra penale siç janë lëndimi i lehtë trupor, në kontekst të dhunës në familje. Prokurorët dhe policia duhet të sigurojnë që çdo raport mjekësor i cili tregon se viktimat e dhunës në familje ka pësuar lëndime fizike të renditet dhe të përfshihet në raportet policore të cilët i përcillen prokurorit.

Mbetemi në shpresë se tema masterit: ***„Dhuna në familje me vështirime të posaqme, keqtrajtimi i fëmijëve në rrethinën e Ferizajit për periudhë 2014-2020,,*** do të ndihmojë sa do pak edhe studjuesit e rinjë në këtë preokupim e problematikë në vete dhe për shoqërinë bashkëkohore.

BIBLIOGRAFIA

1. Agjencia për Barazi Gjinore, "Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, 2013, në: <https://abgj.rksgov.net/Portals/0/>
2. Ismail Dr. Zejneli. *Delikuenca e të miturve*. UNIVERSITY, Tetovë. 2018.
3. Ismail Dr Zejneli. *Criminal Procedural Legislation and respecting of freedom and human rights*. In In 4th International Multidisciplinary Scientific Conference & Arts SGEM 2017, pp. 8. SGEM, 2017, Albena, Bulgaria, 8 / 2017.
4. AI Interview with Andrea Gurakuqi. Peace and Justice Center. Shkodra.
5. Sorrels, Barbara: *Reaching and Teaching Children Exposed to Trauma*, 2015
6. Shahini, Mimoza: *Seminare të zgjedhura nga lënda e psikofiziologjisë*, Prishtinë, 2007
7. Haxhiymeri, Edlira & Kullari, Eliona & Hazizaj, Altin: *Abuzimi i fëmijëve në familje*, Tiranë, 2005
8. Ismail Dr. Zejneli. Some features of corruption in countries in transition with specific emphasis on Republic of Macedonia and Republic of Kosovo.. In In 4th International Multidisciplinary Scientific Conference & Arts SGEM 2017, pp. 9. SGEM, 2017, Albena Co, Bulgaria, 8 / 2017.
9. Baker, L. L. & Jaffe, P. G. (2003). *Youth exposed to domestic violence: A handbook for the Juvenile Justice System to enhance assessment and intervention strategies for youth from violent homes*. Center for children and families in the Justice System. p. 7.
10. Bancroft, L. & Silverman, J. (2002). *The batterer as parent: Addressing the impact of domestic violence on family dynamics*.: Sage, Thousand Oaks, CA.
11. Bornstein, M. (Ed.). (2002). *Handbook of parenting: Vol. 1: Children and parenting* (2nd ed.). Mahwah, NJ: Erlbaum.
12. Dhuna në familje në fokusin e medias – Udhëzues. (2008). Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC). E marrë nga: www.gadc.org.al
13. Holden, G.W. (1998). *Introduction: the development of research into another consequence of family violence*. In: *Children Exposed to Marital Violence: Theory, Research, and Applied Issues* (eds G.W. Holden, R.A. Geffner & E.N. Jouriles), pp. 1–20. American Psychological Association, Washington.

14. Kuvendi i Republikës së Kosovës, “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, Prishtina, Prill 2018,
15. Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082.
16. Komisioni Evropian, ‘Raporti për Kosovën 2019’, Strasburg, Maj 2019.
17. Komisioni Evropian, ‘Raporti për Kosovën 2018’, Strasburg, Prill 2018.
18. Human Rights Watch, “Raporti Botëror 2019”.
19. Ariana Qosaj Mustafa dhe Donjeta Morina, “Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit për autorët e krimit”, Prishtina, Dhjetor 2018
20. Të drejta të barabarta për tërë koalicionin –ERAC, “Strategjia e Kosovës për të drejtat e njeriut 2016-2022: Rruga përpara”, Shtator, 2018.
21. Prishtina Insight, “Ish burri dënohet me burgim të përjetshëm për vrasjen e Valbona Ndrecaj dhe vajzës së tij”, Mars 2019.
22. Rrjeti i Grave kërkon burgim të përjetshëm për Pjetër Ndrecajn për vrasjen e gruas dhe vajzës së tij, Prishtinë, Nëntor 2018
23. Rrjeti i Grave në Kosovë, “RrGK alarmohet nga sulmi i sërishëm ndaj gruas rome ne Ferizaj, Prishtina, Maj 2019.
24. Forumi i Parlamentit Evropian për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese, “Kosovo ta amandamentoit Kushtetuten dhe ta njohë Konventen e Stambollit”, Bruksel, Maj 2019.
25. UN Women Evropa dhe Azia, “Kosova fillon përdorimin e një baze të dhënash për rastet e dhunës në familje”, Prill 2019.

WEP-GRAFIA

- <http://www.unwomen.org/en/what-we-do/ending-violence-against-women/facts-and-figures>
- <https://rm.coe.int/168046031c>
- https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1300/J082v42n01_05_7
- <https://www.koha.net/arberi/74567/rasti-i-vdekjes-se-antigona-morines-tri-dite-pas-martesesskishte-shkuar-fare-ne-apel./;>
- <https://www.koha.net/kronike/119602/aktakuze-per-vrasesin-e-bashkeshortes-dhevajzes-ne-gjakove/>
- <https://www.womensnetwork.org/documents/20151124105025622.pdf>